



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

RAPORTI VJETOR **2013**

DHE

SYNIMET KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN **2014**

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4,
Kati IV, Tiranë

Tel: +355 4 2 234 504

Fax: +355 4 2 234 497

Faqe e internetit: www.caa.gov.al

Email: competition@caa.gov.al

TABELA PËRMBLEDHËSE

FJALA PËRSHENDETËSE E KRYETARIT TË KOMISIONIT	3
I. ZHVILLIMET KRYESORE TË LIGJIT DHE POLITIKËS SË KONKURRENCËS.....	4
I.1 KARAKTERISTIKAT E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS	4
I.2 PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE.....	5
II. ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS	10
II.1. ADMINISTRIMI I ANKESAVE	10
II.2. MARRËVESHJET E NDALUARA	14
II.3. PËRJASHTIM NGA NDALIMI I MARRËVESHJEVE	21
II.4. ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE	21
II.5. KONTROLLI I PËRQËNDRIMEVE	25
II.6. MONITORIMET E TREGUT	28
II.7. RISHIKIMI GJYQËSOR I ÇËSHTJEVE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS	32
II.8. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E KONKURRENCËS	35
III. ADVOKATIA DHE KULTURA E KONKURRENCËS	38
III.1. VLERËSIMI I AKTEVE DHE DRAFT-AKTE NORMATIVE	38
III.2. DHËNIA E REKOMANDIMEVE	39
III.3. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE UDHËZUES MBI ZBATIMIN E LIGJIT TË KONKURRENCËS	40
III.4. KULTURA E KONKURRENCËS – MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT	40
IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	42
IV.1. BASHKËPUNIMI ME KOMISIONIN EUROPIAN	42
IV.2. BASHKËPUNIMI ME OECD (RCC BUDAPEST).....	42
IV.3. BASHKËPUNIMI ME RRJETIT NDËRKOMBËTAR TË KONKURRENCËS (ICN) DHE AUTORITET E RAJONIT.....	43
IV.4. BASHKËPUNIMI ME AGJENCIA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TREGTINË DHE ZHVILLIMIN – UNCTAD	43
V. BURIMET NJERËZORE	45
V.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONET E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS.....	45
V.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE	45
V.3. RITJIA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE	47
V.4. MANAXHIMI FINANCIAR.....	48
VI. PRIORITETET PËR VITIN 2014	49
VI.1. FORCIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT TË KONKURRENCËS	49
VI.2. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT	50
VI.3. HARTIMI I DOKUMENTIT TË RI TË POLITIKËS SË KONKURRENCËS.....	50
VI.4. FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE.....	50
VII. SHTOJCA	52
SHTOJCË 1:TË DHËNA STATISTIKORE MBI VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS SIPAS VITEVE	52
SHTOJCË 2: EKZEKUTIMI I GJOBAVE TË VENDOSURA NGA KOMISIONI I KONKURRENCËS DERI MË 31 DHJETOR 2013	53
SHTOJCË 3: LISTA E VENDIMEVE SHOQËRUAR ME URDHËR EKZEKUTIMI	54
SHTOJCË 4:PËRQËNDRIMET E NJOFTUARA DHE TË AUTORIZUARA.....	55
SHTOJCË 5 KAPITULLI 8: POLITIKA E KONKURRENCËS	56
SHTOJCË 6: RISHIKIMI GJYQËSOR I VENDIMEVE TË KOMISIONIT.....	57
SHTOJCË 7: MATRICA E REKOMANDIMEVE NGA KOMISIONI I KONKURRENCËS PËR VITIN 2013	61
SHTOJCË 8: STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS.....	63
SHTOJCË 9: BUXHETI FAKTIK I AUTORITETIT TË KONKURRENCËS VITI 2013	64

FJALA PËRSHENDETËSE E KRYETARIT TË KOMISIONIT

Zhvillimet e fundit edhe në ekonominë shqiptare evidentojnë gjithnjë e më tepër fjalën e Zëvendës Presidentit të Komisionit European përgjegjës për politikën e konkurrencës se: “Një politikë e fortë e konkurrencës është një nga mjetet më të mira që autoritetet e Bashkimit European duhet të përdorin për të krijuar kushte më të mira për investitorët dhe inovatorët; rrit nivelin e produktivitetit dhe konkurrueshmërinë kundrejt partnerëve globalë që janë më shumë dinamikë.” Për më tepër, funksionimi sa më i mirë i tregjeve është një domosdoshmëri për të rritur mirëqenien e qytetarëve.

Rritja e qëndrueshme ekonomike përfshin procesin e daljes nga tregu të disa firmave dhe disa të tjera, ato më eficiente, inovative dhe produktive, hyjnë në treg, zgjerohen duke krijuar aktivitete të tjera, pra hapin tregje të reja. Konkurrenca është një nga faktorët kryesorë që i nxit firmat që të bëhen më eficiente në mënyrë që të jenë në krye të garës. Gjithashtu, konkurrenca mundëson që firmat me produktivitet më të lartë të zëvendësojnë firmat më pak eficiente. Nxitja e përhershme e kësaj ligjësie të tregut, kërkon politika publike që nxisin rritjen ekonomike, duke i motivuar firmat të investojnë dhe të zhvillohen.

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të politikës dhe ligjit të konkurrencës krijon kushte për një treg sa më funksional, duke luftuar praktikant anti-konkurrese që shfaqen në formën e marrëveshjeve të ndaluara dhe karteleve; ndalimit të praktikave abuzuese në mënyrë që hyrësit e rinj të mund të sfidojnë ndërmarrjet ekzistuese; duke nxitur bashkimet e ndërmarrjeve që çojnë në kompani akoma më konkurruese, si dhe duke ndaluar ato bashkime që mund të çojnë në pozita dominuese që kërcënojnë konkurrencën; duke vlerësuar aktet ligjore dhe nënligjore për të parandaluar kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës apo që mbështesin kompanitë jo-eficiente dhe duke mbështetur masat që ndërmerr shteti për të nxitur e promovuar konkurrencën dhe interesin e përgjithshëm publik. Pikërisht, kjo është puna e përditshme e institucionit të konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës nuk e ka zbatuar ligjin dhe politikën e konkurrencës në mënyrë pasive, vetëm në përgjigje të praktikave anti-konkurrese në një sektor të caktuar, por në mënyrë aktive, duke e konsideruar atë si pjesë së të tërës. Shembuj mund të jepen në sektorin e telekomunikacioneve, energjisë, dhe atë financiar, duke nxitur përdorimin e instrumentave që rrisin transparencën e tregjeve si një nga instrumentat bazë të nxitjes së konkurrencës.

Institucioni i konkurrencës nuk vlerëson rastet apo merr vendime në vakum. Si gjithë politikat e tjera publike, politika e konkurrencës duhet të marrë parasysh kushtet ekonomike dhe sociale të vendit. Gjithashtu, gjatë viteve, politika e konkurrencës është integruar gjithnjë e më shumë me politikat e zhvillimit sektorial, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me entet rregullatorë sektorialë, për nxitjen dhe mbrojtjen ex-ante të konkurrencës.

Aspektet kryesore të punës së institucionit të konkurrencës përfshihen në tre koncepte bazë: hapja e tregjeve, integrimi dhe bashkëpunimi, të cilat përshkruajnë më së miri punën e këtij institucioni.

I. ZHVILLIMET KRYESORE TË LIGJIT DHE POLITIKËS SË KONKURRENCËS

Kuadri kushtetues sanksionon që sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë "...bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike". Kuadri ligjor i ndërtuar në zbatim të Kushtetutës, Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar) dhe Politika Kombëtare e Konkurrencës, janë instrumentat që garantojnë realizimin e këtij parimi të Kushtetutës. Institucioni përgjegjës i ngarkuar nga ligji për mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës së lirë në tregun shqiptar është Autoriteti i Konkurrencës. Ky institucion publik funksionon jo vetëm në zbatim të ligjit dhe të politikës së konkurrencës, por edhe të normave dhe praktikave më të mira të administratës publike dhe të së drejtës europiane të konkurrencës, në zbatim në detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizimit e Asocimit (MSA). Krahas kësaj, për të patur një konkurrencë reale dhe të ndershme në treg, kërkohet zbatimi me rigorozitet i të gjithë kuadrit ligjor për pronësinë industriale, mbrojtjen e konsumatorit, konkurrencën e pandershme në bazë të kodit civil, legjislacionin tatimor e doganor, etj., duke garantuar trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të lojtarëve të tregut.

1.1 Karakteristikat e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës

Për realizimin e misionit të përcaktuar në ligjin bazë të konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës përdor instrumentet ligjorë siç janë procedurat investigative dhe hetimore për të zbuluar dhe penalizuar praktikant anti-konkurrese. Këto praktika shfaqen në formën e : marrëveshjeve të ndaluara për fiksimin e çmimeve, ndarjen e tregjeve, kufizimin apo kontrollin e prodhimit; të abuzimit me pozitën dominuese në formën e vendosjes së çmimeve të padrejta, kufizimin e prodhimit apo të shërbimit, vendosjen në pozita jo të barabarta të klientëve, apo vendosja e kushteve dhe detyrimeve shtesë në kontratë me palët e treta etj. Autoriteti i Konkurrencës është përgjegjës edhe për kontrollin e përqendrimeve të ndërmarrjeve, të cilat përfshihen në transaksionet e shitblerjes së aksioneve midis tyre, për të mos lejuar krijimin ose forcimin e pozitës dominuese në tregjet përkatëse. Promovimi dhe nxitja e lojës së lirë të ndërmarrjeve në treg, përbën një nga objektivat e ligjit, i cili realizohet nëpërmjet instrumentit të advokacisë dhe aktiviteteve për rritjen e kulturës së konkurrencës.

Ligji "Për mbrojtjen e konkurrencës" në të gjitha aspektet e tij është i përafëruar në një shkallë të gjerë me *acquis-communitaire*, jo vetëm në përmbajtje, por edhe në mënyrën e instrumentet e zbatimit të tij. Këto instrumenta nuk përdoren për të vlerësuar sjelljen e lojtarëve të tregut, por edhe për të parandaluar, promovuar e nxitur barazinë në treg nëpërmjet vlerësimit dhe dhënies së rekomandimeve për aktet ligjore dhe nënligjore ekzistuese dhe atyre që draftohen nga institucionet qendrorë e vendore, si dhe të enteve rregullatorë. Në mënyrë të veçantë, zbatimi me efikasitet të ligjit, kërkon vlerësimin e atyre akteve ligjore dhe nënligjore që lidhin me kufizimet sasiore në treg, apo me dhënien e të drejtave ekskluzive apo të veçanta.

Aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të ligjit synon ta bëjë tregun sa më funksional. Në këtë këndvështrim, mirëfunksionimi i tregjeve kërkon kujdesin si për mirëqenien e konsumatorëve, ashtu edhe për t'i bërë tregjet sa më konkurruese. Pikërisht kjo përbën filozofinë në të cilën është mbështetur Komisioni i Konkurrencës në procesin e vendimmarrjes së tij.

Një nga karakteristikat e politikës dhe ligjit të konkurrencës është gjithë përfshirja, e cila përbën një nga aspektet e përhershme të veprimtarisë së institucionit të konkurrencës që është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me Parlamentin, institucionet qendrorë dhe vendore, entet rregullatorë, bizneset e organizatat e tyre, si dhe shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.

1.2 Përmbledhje e zhvillimeve kryesore

Viti 2013 shënon 10 vjet eksperiencë në zbatimin të ligjit shqiptar të konkurrencës. Këto eksperiencë kanë mundësuar rritjen dhe konsolidimin e Autoritetit të Konkurrencës, si mbikëqyrësi kryesor i konkurrencës në treg.

Për realizimin e aktivitetit gjatë vitit të kaluar, institucioni i konkurrencës është mbështetur në rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012” dhe raportin e progresit të Komisionit Europian, në zbatim të ligjit bazë dhe legjislacionit dytësor. Forcimi i zbatimit të ligjit nëpërmjet përdorimit të instrumentave dhe rritjes së efikasitetit të ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës në mbrojtje të lojës së lirë të aktorëve të tregut, ka qenë objektivi i aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2013.

Veçoria e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit të kaluar është jo vetëm rritja e numrit të **ankesave** të depozituara, por kryesisht rritja e numrit të atyre që i adresohen Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Ky fakt është një tregues i rritjes së kulturës së biznesit mbi ligjin e konkurrencës dhe i rritjes së besimit për rolin e Autoritetit të Konkurrencës, por nga ana tjetër përbën edhe një nga sfidat për trajtimin e shpejtë e me profesionalizëm nga specialistët e institucionit, si dhe ruajtja e konfidencialitetit. Gjatë vitit 2013 Autoritetit i janë adresuar 16 ankesa nga të cilat: 4 (katër) ankesa janë për marrëveshje të ndaluara apo sjellje të bashkërenduara; 8 (tetë) ankesa janë për abuzimin me pozitën dominuese të një apo disa ndërmarrjeve; 1(një) ankesë për revokimin e vendimit të Komisionit si dhe 3 (tre) ankesa që nuk ishin në përputhje me objektin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Objekt i ankesave të ndërmarrjeve kanë qenë kryesisht në tregun e ngarkim-shkarkimit në rrugë detare të gazit të lëngshëm, në tregun e komunikimeve elektronike, në tregun e energjisë elektrike, në tregun e prokurimeve publike, në tregun e sigurimeve, në tregun e transportit urban të qytetit të Tiranës, nëpërmjet të cilave janë prezantuar shqetësimet e operatorëve për kufizime të mundshme të konkurrencës të shkaktuara nga operatorët apo grupe operatorësh të tjerë. Bazuar në këto ankesa janë ndërmarrë procedurat e monitorimit dhe të hetimit nga Sekretariati, në zbatim të parimeve të kodit të procedurës administrative dhe kuadrin ligjor të konkurrencës, si dhe janë trajtuar gjerësisht në mbledhjet e Komisionit të Konkurrencës, i cili ka ndërmarrë vendimmarrjen përkatëse.

Përgjatë kësaj periudhe kohore, Komisioni i Konkurrencës ka **marrë 42 vendime**: 2(dy) vendime për gjoba, (1 për praktika antikonkurrese dhe 1 për mos njoftimin e përqëndrimeve); 13 (trembëdhjetë) vendime për autorizimin e kontrollit të përqëndrimeve; 1(një) vendim për dhënie rekomandimesh për institucionet publike dhe entet rregullatorë në kuadër të advokacisë së konkurrencës (pa përfshirë opinionet e Komisionit të Konkurrencës të dhëna jo në formë vendimi); 3 (tre) vendime për bazën ligjore sekondare; 2 (dy) vendime për aktet nënligjore të së drejtës së konkurrencës; dhe vendimet e tjera janë procedurale (përfshirë vendimet për hapje hetimi paraprak, hapje hetimi të thelluar, etj.). Katër vendime të Komisionit janë me mendime pakice, nga të cilat tre janë për kontrollin e përqëndrimeve dhe një për marrëveshje të ndaluar, të cilat janë të publikuara në website së bashku me vendimet përkatëse.

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar trajtimi i problematikave të mbartura nga viti 2012 në tregje të tilla si: prodhimi, importi dhe tregtimi me shumicë i vajit vegjetal; prodhimi, importi dhe tregtimi me shumicë i çimentos; tregu i transportit urban qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës; tregu i telefonisë celulare me pakicë. Sikurse janë realizuar procedurat e monitorimit dhe të hetimit në tregjet si: ngarkim-shkarkimi në rrugë detare të gazit të lëngshëm; telekomunikacioneve; energjisë elektrike; tregu i prokurimeve publike i shërbimit të ruajtjes fizike; tregu i i prodhimit, importit dhe shitja me shumicë e karburanteve; si dhe tregu i sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike. Këto raste kryesisht, janë filluar bazuar në ankesat e ndërmarrjeve në tregjet përkatëse, të cilat adresojnë shqetësime për sjelljet antikonkurrese të ndërmarrjeve me fuqi tregu apo të grupimeve të ndërmarrjeve.

Eksperiencia e grumbulluar gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” tregon se është rritur numri i ankesave për **marrëveshje të ndaluara**, tregues i rritjes së shkallës së njohjes së të drejtës së konkurrencës kryesisht në bizneset dhe tregjet ku janë zhvilluar monitorime dhe hetime të Autoritetit të Konkurrencës. Por, në të njëjtën kohë, është rritur shkalla e vështirësisë së gjetjes së evidencave direkte që do të provonin ekzistencën e marrëveshjeve të ndaluara. Për këto arsye, Autoriteti i Konkurrencës është përqëndruar në rritjen e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet zbatimit të teknikave bashkëkohore të evidentimit të marrëveshjeve të ndaluara dhe rritjes së kapaciteteve administrative për shqyrtimin e karteleve nëpërmjet analizave ekonomike dhe ekonometrike. Ky fakt është evidentuar gjatë shqyrtimit të rasteve në tregun e vajit dhe të çimentos.

Gjatë trajtimit të rasteve që lidhen me **abuzimet me pozitën dominuese** është evidentuar rëndësia dhe roli i enteve rregullatorë në tregjet e rregulluara, si në atë të telekomunikacionit apo të energjisë, apo rëndësia që ka roli i shtetit si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i zbatimit të detyrimeve kontraktuale në shërbimet e dhëna me konçesion si në rastin e konçesionit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare.

Gjatë vitit 2013, janë shqyrtuar dhe autorizuar 13 praktika të shit/blerjes së transaksioneve, të cilat kanë sjellë përfundimin e kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqëndrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit

në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqendruar. Përqendrimet kryesore kanë ndodhur në tregun e energjisë elektrike, ndërtimit, shitjes me pakicë etj., dhe në asnjë nga rastet e shqyrtuara nuk ka patur shqetësime për kufizim të konkurrencën në formën e krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

Forcimi i zbatimit të ligjit është konsideruar e lidhur ngushtë me plotësimin dhe përmirësimin e **kuadrit nënligjor** të konkurrencës, proces i cili synon edhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me të drejtën europiane në fushën e konkurrencës. Risia e procesit të miratimit të akteve nënligjore për vitin 2013 konsiston tek konsultimi publik dhe organizimi i tryezave të rrumbullakëta me studiot ligjore të cilat paraqitën komentet dhe vlerësimet e tyre, si përdorues të drejtpërdrejtë të së drejtës shqiptare të konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës ka hartuar dhe miratuar aktet nënligjore të parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, në të cilën përfshihet: rregullorja për kategori të caktuara të marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve si dhe në sektorin e transportit ajror, për zbatimin e nenit 6 të ligjit, përjashtimet në bllok të marrëveshjeve midis ndërmarrjeve që operojnë në sektorët përkatës. Gjithashtu, është miratuar udhëzuesi për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale, i cili përbën një manual pune për ekspertët e konkurrencës, si të institucionit të konkurrencës, ashtu edhe për palët e treta të interesuar për zbatimin e ligjit. Proçesi i hartimit dhe i miratimit të këtyre akteve nënligjore është përdorur si instrument për forcimin e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës në ambientin që na rrethon.

Efekti i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës është i lidhur me shkallën e zbatimit të tyre. Vendimet e Komisionit të Konkurrencës, të cilat i adresohen ndërmarrjeve për shkeljet e provuara të ligjit në formën e abuzimit me pozitën dominuese apo në formën e pjesëmarrjes në marrëveshjet e ndaluara, dhe që konkludojnë me gjoba, janë objekt **shqyrtimi në gjykatë**. Gjatë vitit të kaluar, në të tre shkallët e gjyqësorit, kanë qenë për shqyrtim 27 çështje prej të cilave, 16 raste mbeten për shqyrtim në 2014 dhe 11 prej tyre shqyrtuar në 2013 duke rezultuar përkohësisht: pesë të humbura, pesë të fituara dhe një dërguar për rishqyrtim për efekt mos-kompetencë në Gjykatën Administrative.

Nëse i referohemi statistikave për vitin 2013, të cilat janë mjaft të detajuara në shtojcat e këtij raporti, në Gjykatën e Shkallës së Parë, janë trajtuar gjithsej 8 vendime të Komisionit të Konkurrencës, nga të cilat 2 procese kanë konfirmuar vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, 3 vendime të Komisionit të Konkurrencës janë rrëzuar dhe 3 raste janë në proces shqyrtimi. Në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2013 kanë qenë për shqyrtim 8 çështje, nga të cilat mbeten 4 për t'u shqyrtuar në 2014 dhe 4 janë shqyrtuar. Nga këto të fundit 2 vendime të Komisionit të Konkurrencës janë rrëzuar, 1 vendim i Komisionit të Konkurrencës u konfirmua dhe tjetri i kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative, ku pritet të kalojnë edhe 4 çështje të mbetura për shqyrtim në 2014. Ndërsa në Gjykatën e Lartë gjatë 2013, të cilat janë mbartur nga vitet e kaluara, kanë qenë 11 çështje për shqyrtim, nga të cilat vetëm për 1 rast është vendosur mospranim i rekursit të paraqitur nga ndërmarrja, duke konfirmuar përfundimisht vendimin e Komisionit të Konkurrencës në tregun e telefonisë celulare. Vendimi i Komisionit të Konkurrencës për vendosje gjobe ndaj një ndërmarrje në tregun e telefonisë celulare për mos dhënie informacioni gjatë procedurës hetimore, e dhjetorit 2005 është

shqyrtuar, pas rekursit të Autoritetit për të cilën Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin për rigjykim në Gjykatën e Apelit, kurse 9 mbeten për shqyrtim në 2014. Rasti i përmendur, rekursi i të cilit është depozituar që në vitin 2008, evidenton problematikën e kohëzgjatjes së trajtimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës në sistemin gjyqësor, i cili përbën një nga shqetësimet kryesore pasi lidhet me efektin që sjellin ndërhyrjet në treg të Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë këndvështrim, fillimi i Gjykatës Administrative në fillim të këtij viti përbën edhe një instrument shumë të rëndësishëm i cili do të ndikojë jo vetëm në shkurtimin e afateve, por pritet që edhe shkalla e ekspertizës së trajtimit të çështjeve të konkurrencës të përmirësohet ndjeshëm, duke sjellë edhe rritjen e cilësisë së analizave të institucionit në konkurrencës si dhe të vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës nuk ndërhyr në treg vetëm nëpërmjet instrumentit të gjobës për ndërmarrjet, por gjithashtu, për realizimin e misionit të tij për konkurrencë të lirë dhe efektive, përdor edhe instrumentin e **advokacisë**, nëpërmjet vendimeve që adresojnë rekomandime për entet rregullatorë të tregjeve specifike apo institucioneve të tjera qendrorë. Prandaj, për rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve në treg, Autoriteti i Konkurrencës e konsideron jetike bashkëpunimin me entet rregullatorë dhe institucionet publike, nëpërmjet të cilit zbatohet advokacia, si shtylla e katërt e ligjit. Për këtë qëllim janë përmirësuar më tej instrumentat e komunikimit jo vetëm në organizimin e tryezave të përbashkëta në nivel ekspertësh dhe të bordeve vendimmarrëse, por edhe nëpërmjet takimeve për të ndarë shqetësimet apo opinionet midis ekspertëve të institucioneve. Këto instrumenta të komunikimit synojnë jo vetëm thjesht adresimin e rekomandimeve por edhe diskutimin mbi masat që mund të ndërmerren në periudhat afatshkurtra apo afatgjata, të cilat synojnë mirëfunksionimin e tregjeve të rregulluara. Këto praktika janë ndjekur me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Entin Rregullator të Energjisë (ERE) si dhe Autoritetin e Aviacionit Civil

Aspektet e advokacisë gjithmonë janë parë të lidhura ngushtë me aspektet e rritjes së kulturës së konkurrencës. Risia e vitit të kaluar ka qenë që pothuajse të gjitha rregulloret dhe udhëzuesit janë miratuar pasi kanë kaluar procesin e konsultimit publik duke u publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit, si dhe sensibilizuar palët e interesit nëpërmjet njoftimeve për mediat, të cilat kanë qenë koherente për të gjitha vendimet finale të Komisionit të Konkurrencës. Pjesë e tryezave konsultative me publikun nuk kanë qenë vetëm përfaqësuesit e biznesit, por edhe studiot ligjore si pjesë e sistemit të zbatimit me korrektësi të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Forcimi i kapaciteteve institucionale të institucionit të konkurrencës ka qenë edhe një nga prioritetet e vitit të kaluar dhe që përbëjnë edhe një nga sfidat e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës për t’ju përgjigjur me ndërhyrje gjithnjë e më të shpejta e me cilësi kërkesave për mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës midis lojtarëve të tregut. Krahas kualifikimit të vazhdueshëm, është përdorur rishikimit i të rasteve pasi përfundon tërësisht procesi, pra edhe vendimmarrja e Komisionit, nga të gjithë punonjësit e Sekretariatit të konkurrencës. Ky proces është konsideruar si një instrument për të mësuar nga ato elemente të procedurës apo analizave ekonomike, apo të sigurimit të provës që nuk janë performuar me cilësi. Pra të mësuarit nga gabimet është një nga instrumentat e tjerë që po përdor institucioni i konkurrencës.

Profili publik i Autoritetit të Konkurrencës ka njohur zhvillime intensive gjatë vitit 2013 duke shënuar rritje të kulturës dhe shkallës së njohjes së ligjit dhe politikës së konkurrencës në Shqipëri. Një sërë artikujsh në median e shkruar dhe atë vizive mbi vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, pjesëmarrja aktive në konferenca dhe workshope nga përfaqësuesit e Autoritetit dhe prezantimet e ekspertëve në konferencat ndërkombëtare kanë ndikuar në rritjen e profilit publik në ambientin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar të Autoritetit të Konkurrencës.

Raporti vjetor është konceptuar në gjashtë pjesë kryesore duke filluar me zhvillimet kryesore në zbatimin e ligjit dhe politikës së konkurrencës, aktivitetet zbatuese në pjesën e dytë të ndara sipas kolonave kryesore të ligjit: abuzim me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara, kontrollin e përqëndrimeve dhe rishikimin gjyqësor, për të vijuar me pjesën e tretë me aktivitetin e advokacisë së konkurrencës, pjesa e katërt lidhet me bashkëpunimin ndërkombëtar kryesisht me Komisionin Europian, pjesa e pestë me kapacitetet administrative të ngarkuara me zbatimin e ligjit dhe pjesa e fundit i referohet prioriteteve të punës së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014.

II. ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS

Aktiviteti kryesor i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013 ka qenë në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe ka përdorur të gjitha instrumentat ligjorë për forcimin e zbatimit të ligjit, kryesisht në tre kolonat kryesore, ndalimin e marrëveshjeve të ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese dhe kontrollin e përqëndrimeve në funksion të kontrollit dhe të parandalimit e krijimit apo forcimit të pozicionit dominues në treg.

Proçedurat e monitorimit dhe hetimit të kushteve të tregut fillojnë mbi bazën e ankesave nga palët e prekura, me nismën e vetë Autoritetit dhe sa herë kërkohet nga Kuvendi. Karakteristikë e vitit të kaluar ka qenë se këto proçedura janë ndërmarrë kryesisht mbi bazën e ankesave, një cilësi kjo e institucioneve të konkurrencës me eksperiencë të konsoliduar. Për të evidentuar tipologjinë e ankesave, në vijim paraqitet një përshkrim i shkurtër i ankesave të depozituara në Autoritet gjatë vitit 2013, si dhe vlerësimi i tyre.

II.1 Administrimi i ankesave

Vitet e fundit vihet re një rritje sasiore dhe cilësore e ankesave të lojtarëve të tregut si dhe të konsumatorëve për shkelje të mundshme të konkurrencës në një sektor apo treg të ekonomisë. Instrumenti i administrimit të ankesës ka kaluar në një proçes të përmirësimit të vazhdueshëm, i cili ka synuar shkurtimin e afateve të vlerësimit paraprak.

Gjatë vitit 2013, pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrjet që operojnë në tregje të ndryshme kanë depozituar 16 ankesa, nga të cilat 3 prej tyre nuk ishin objekt sipas fushës së veprimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe 10 ankesa janë vlerësuar dhe janë trajtuar duke përdorur instrumentin e monitorimit, hetimin paraprak, apo hetimin e thelluar sipas analizave dhe evidencave të siguruara.

II.1.1 Ankesa sipas objektit të ligjit

Ankesat të cilat janë vlerësuar në objektin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” kanë qenë kryesisht në tregun e komunikimeve elektronike, energjisë elektrike, prokurimet publike, shërbimet portuale të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm, tregun e sigurimeve etj.

Një risi e paraqitjes së ankesave nga palët e interesit lidhet me një argumentim më të mirë ligjor dhe në disa raste të përforcuar me marrjen e firmave ligjore për avokatinë e ankesave të paraqitura gjë që rrit shkallën profesionale të objektit dhe argumentimit të ankesave.

Në mënyrë më të detajuar ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2013 të ndara sipas tregjeve janë si vijon:

- *Në tregun e shërbimeve portuale (gazi i lëngshëm)*

Ndërmarrja “Prima Gas Albania” vs “Romano Port”

Ankesa adresohet ndaj konçesionarit të pontilit të ngarkim/shkarkimit në Porto Romano, ndërmarrjes “Romano Port” SHA, duke pretenduar se kjo ndërmarrje nuk zbatonte rregulloren e funksionimit të portit duke lejuar jashtë radhe shkarkimin e anijeve të tjera, ndërkohë që anija e Prima Gas Albania mbetet në pritje. Mbi bazën e ankesës u realizuan procedurat e monitorimit dhe të hetimit paraprak, ku objekt hetimi u përcaktua periudha kohore një vjeçare. Bazuar në faktet dhe evidencat e grumbulluara për të gjitha praktikatat e ngarkim/shkarkimit të realizuara nga ana e konçesionarit për periudhën hetimore, si dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese “Romano Port” SHA, Komisioni i Konkurrencës arriti në përfundimin se nuk ka shenja të abuzimit me pozitën dominuese nga ana e ndërmarrjes Romano Port SHA, të parashikuara në nenin 9 të Ligjit. Autoriteti i Konkurrencës i rekomandoi Organit Shtetëror të Autorizuar si mbikëqyrësi i zbatimit të marrëveshjes konçesionare detajimin e mëtejshëm të rregullores së funksionimit të këtij porti.

- *Në tregun e komunikimeve elektronike*

Ndërmarrja “ENET” ShPK vs “Albtelekom” sha

Kjo ankesë kishte për objekt mosmarrëveshjet për lidhjen e marrëveshjes së interkonjeksionit. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për interkonjeksionet në tregun e komunikimeve elektronike rregullohen fillimisht nga rregullatori, për këtë arsye iu drejtua Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për informacion të mëtejshëm, i cili na njofton me anë të vendimit nr. 2327, datë 28.06.2013 se filloi procedimi administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis “ENET” ShPK dhe “Albtelekom” sha.

Ndërmarrja “NISATEL”sh.p.k. vs “Albtelekom” Sh.a,

Ankimuesi pretendonte se ndërmarrja “Albtelekom” nuk kishte zbatuar kushtet teknike të kontratës së lidhur midis palëve për ofrimin me shumicë të shërbimit të internetit broadband dhe njëkohësisht kishte vendosur kushte shtesë duke abuzuar me çmimet e ofruara ndaj ndërmarrjes “Nisatel” sh.p.k duke shfrytëzuar pozicionin e saj në tregun e shumicës dhe atë të pakicës (integrimin vertikal). Pas vlerësimit të ankesës dhe procesit të monitorimit, bazuar në analizën e fakteve dhe të kushteve të tregut u konkludua se nuk ka kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës në treg nga operatori “Albtelekom”.

Ndërmarrja “Plus Communication”

Ndërmarrja “Plus Communication”, në vijim të ankesës së depozituar në fund të vitit 2012, mbi sjelljen e mundshme abuzive të ndërmarrjes “Vodafone Albania” sha, në fund të muajit janar 2013 ka kërkuar zgjerimin e periudhës së hetimit edhe për vitin 2011. Kjo kërkesë u morr në konsideratë nga Autoriteti i Konkurrencës, fakt i cili është i shprehur në vendimmarrjen përkatëse të Komisionit të Konkurrencës.

- *Në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes/sigurisë fizike*

Ndërmarrjet “Anakonda” SHRSF dhe “Taulantia” SHRSF

Ndërmarrjet kanë adresuar ankesa të ndërsjella në lidhje me tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës.

Bazuar në këto ankesa u realizuan procedurat investigative nga të cilat nuk u gjetën evidenca direkte apo indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës për periudhën nën hetim. Në përfundim të procedurave të hetimit paraprak u konkludua se nuk kishte shenja të një kufizimi të mundshëm të konkurrencës në kuptim të nenit 4 të ligjit.

Bashkimi Kombëtar i Shoqërive të ruajtjes dhe sigurisë fizike ka denoncuar për korrupsion në tenderët e ruajtjes dhe sigurisë fizike për Universitetin e Tiranës, Ujësjellës-Kanalizime dhe Universiteti Politeknik për tenderët e muajit dhjetor 2013, të cilat nuk janë publikuar në kohë duke shkelur rregullat e prokurimit publik.

Nga vlerësimi i ankesës u konstatua se për raste të ngjashme, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me anë të vendimit nr. 114 datë 26.5.2009, ku ka vendosur t'i rekomandojë Agjencisë së Prokurimeve Publike që në varësi të natyrës së kontratës që prokurohet të bëhet ndarja e kontratave në lote dhe/ose nënlote, në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja sa më e gjerë në procedurën e prokurimit publik dhe nxitjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ky gjykim iu bë me dije ankimesit.

- *Në tregun e sigurimeve të detyrueshme*

Ndërmarrja “ATLANTIK” SHA,

Kjo ndërmarrje adresonte shqetësimin se disa shoqëri të tregut të sigurimeve operonin me çmime tepër të ulëta jashtë çdo niveli të miratuar të primit të riskut nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, fenomen ky që po i shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm jo vetëm kompanive të sigurimit, por edhe vetë konsumatorëve. Në mënyrë të menjëhershme ky shqetësim iu adresua rregullatorit përkatës si dhe ju kërkua informacion mbi faktet që mund të ishin identifikuar nga shitjet online, planet e biznesit të kompanive, si dhe njoftimi i institucionit të konkurrencës mbi trajtimin e kësaj problematike.

Agjent sigurimesh

Pranë Autoritetit të Konkurrencës një agjent sigurimesh me datën 28.08.2013 ka dërguar një ankesë në formë elektronike se tre shoqëri sigurimesh të grupit Vienna Insurance Group sillen në mënyrë të koordinuar dhe se këto shoqëri zotërohen nga i njëjti aksioner, por veprojnë në mënyrë të pavarur dhe se transaksioni ka qenë jo real. Komisioni i Konkurrencës kur ka shqyrtuar autorizimin e përqendrimit në këtë treg, është shprehur për monitorimin e tregut për të adresuar këtë shqetësim (për më shumë vendimi nr. 199, datë 15.09.2011). Nga monitorimi i proceseve vendimmarrëse në nivelin strategjik dhe të menaxhimit operacional u konstatua se kompanitë aplikonin politika të pavarura për menaxhimin operacional.

Individ

Një punonjës pranë një ndërmarrje sigurimesh ka paraqitur një ankesë në formë elektronike protokolluar pranë Autoritetit me nr.480 Prot të datës 11.12.2013 mbi mundësinë e fiksimit të çmimeve dhe marrëveshjeve të fshehta në tregun e sigurimeve të detyrueshme. Autoriteti i Konkurrencës e ka informuar ankimesin se po e shqyrton këtë ankesë në kuadër të procedurave hetimore të hapura me vendimin e Komisionit

të Konkurrencës nr. 297, datë 18.11.2013 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

- *Në tregun e energjisë elektrike*

Ndërmarrja “Gen-I” vs “CEZ Shpërndarje”

Ankesa e ndërmarrjes “GEN-I” adresonte shqetësimet mbi procedurat e prokurimit vjetor të energjisë elektrike të blerë për mbulimin e humbjeve nga “CEZ” sha. Gjithashtu, janë depozituar disa ankesa, të cilat janë trajtuar në vazhdimësi, në lidhje me tenderët mujorë të energjisë elektrike për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2013. Nga ana e ankimesit është pretenduar se “...termat dhe kushtet financiare të vendosura nga Cez Shpërndarje sjellin kufizim të numrit të pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit, kjo situatë do të sjellë kufizim të numrit të pjesëmarrësve dhe përpiqet të përfitojë nga pozicioni dominues me anë të vendosjes së kushteve të padrejta të tregimit me pasojë shtrembërimin e konkurrencës së lirë në tregun e energjisë elektrike dhe dëmtimin e konsumatorëve fundorë, të cilët duhet të paguajnë kosto më të larta të blerjes së energjisë elektrike...”. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës u mbledhën informacionet e nevojshme nga palët e përfshira në proces si dhe u realizua një seancë dëgjimore me ndërmarrjen “CEZ Shpërndarje”. Gjatë procesit të vlerësimit të ankesës është bashkëpunuar ngushtësisht me Entin Rregullator të Energjisë. Në vijim të procesit, Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr.301, datë 06.12.2013, vendosi mbylljen e procedurës së vlerësimit të ankesës së ndërmarrjes GEN-I Tirana në tregun e tregimit më shumicë të energjisë elektrike dhe se Cez Shpërndarje Sh.a ka vepruar konform rregullores së miratuar nga ERE për “Rregullat dhe procedurat standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH”.

- *Në tregun e transportin qytetas*

Ndërmarrja “Gerard A” Sh.p.k vs Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas

Kjo ndërmarrje është ankuar pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresat 96 Prot datë 25.02.2013 dhe 96/2 Prot datë 01.04.2013 në lidhje me problematikën e kartonit shoqëruar të aboneve të nxjerrë nga Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas duke kontrolluar tregun në sasinë e aboneve që shpërndajnë duke deformuar konkurrencën në treg. Kjo ankesë u trajtua në kuadrin e procesit të hetimit të realizuar në këtë treg, i cili trajtohet në mënyrë më të detajuar në vijim të këtij raporti.

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas është ankuar pranë Autoritetit të Konkurrencës ndaj Bashkisë së Tiranës për planifikim të sasive më të larta të biletave të pajtimit mujor për shoqërinë e re “Gerard A” në transportin qytetas të Tiranës.

Autoriteti i Konkurrencës i ka trajtuar të dyja ankesat në kuadër të hetimit për shkeljen e mundshme në konkurrencës në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 262, datë 14.01.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.

Procedurat hetimore në këtë treg janë konkluduar me vendimin e Komisionit nr.290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Sh.p.k, “Alba Trans” Sh.p.k, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” ShPK, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.

II.1.2 Ankesa të tjera

Autoriteti i Konkurrencës ka mbajtur një rol proaktiv edhe për ankesat, objekti i të cilave nuk përputhet me objektin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” duke iu adresuar për zgjidhje institucioneve të tjera përkatëse në varësi të specifikave, si dhe ka njoftuar palët ankimuese për vijimin e procedurave nga institucionet përgjegjëse.

- Mbi aplikimin e TVSH-së në tregun e reklamave

Shoqata Shqiptare e Agjencive të reklamave ka paraqitur një kërkesë për konsiderimin e shqetësimeve të agjencive të reklamave lidhur me aplikimin e TVSH-së sipas një projektligji të ri për TVSH-ë që mund të ndryshonte në mënyrë rrënjësore mënyrën se si gjithë zinxhiri i shërbimeve të këtij sektori që faturon dhe aplikon TVSH-në ku operatorët të të njëjtit treg do aplikonin shkallë të ndryshme të taksës. Në përgjigje të ankesës Autoriteti i Konkurrencës u shpreh se do të bëjë vlerësimin paraprak të draft-ligjit “Për disa ndryshme në TVSH-në” në momentin e vënies në dispozicion nga Ministria e Financave.

- Në tregun e tregtimit të ujit të pijshëm

Shoqëria Blu Imperial ShPK ka paraqitur një ankesë për konkurrencë të pandershme të shoqërive të tjera që tregtojnë ujë të ambalazhuar me emërtimin “Selita”. Pas vlerësimit të ankesës është informuar ankimuesi me shkresën 416/1 datë 8.11.2013 se ankesa nuk është në objektin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Në tregun e shërbimeve portuale

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “EMS APO” ShPK ka paraqitur një ankesë për dijeni për Autoritetin e Konkurrencës në datën 29.12.2013 mbi shkarkimin e një anije të ngarkuar me hekur, e cila nuk është lejuar të shkarkojë në Portin e Durrësit. Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën 498/1 Prot të datës 15.01.2014 e ka informuar ankimuesin mbi shqyrtimin e ankesën vetëm në këndvështrimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ndërkohë ka kërkuar vënien në dispozicion të një kopje të plotë të kontratës konçesionare për ndërmarrjen “EMS Shipping & Trading GmbH”.

II.2. Marrëveshjet e ndaluara

Neni 4 i Ligjit ashtu si edhe neni 101 i Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Europian (TFEU), ndalon marrëveshjet që kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg. Ky nen ka për afuar plotësisht dispozitat e TFEU, dhe nuk ka ndryshim ndërmjet pengimit, kufizimit apo shtrembërimit të

konkurrencës. Të gjitha këto veprime konsiderohen si antiligjore dhe cenojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Me termin “marrëveshje” do të kuptojmë marrëveshje të çdo forme, të lidhur midis ndërmarrjeve, me apo pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikën e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, pra marrëveshje horizontale ose në nivele të ndryshme, pra marrëveshje vertikale. Marrëveshje do të thotë konsensus ndërmjet palëve, i cili kufizon apo ka të ngjarë të kufizojë lirinë e tyre tregtuese nëpërmjet përcaktimit të formës së veprimeve të tyre në treg.

Forma e marrëveshjeve nuk është aspak e rëndësishme parë në këndvështrimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sipas të drejtës së konkurrencës, çdo lloj bisedimi, qoftë ky formal ose jo, nënkupton marrëveshje sipas ligjit. Në rastet kur konkurrentët nuk bisedojnë drejtpërdrejtë, por merren vesh në mënyrë të heshtur ose me veprime konkludente, kjo praktikë mbulohet nga nocioni i marrëveshjes. E rëndësishme është shprehja e vullnetit të përbashkët të palëve dhe dëshira që veprimi i kryer të ketë pasoja direkte ose indirekte mbi konkurrencën, ndërsa forma e shprehjes së vullnetit dhe dëshirës nuk përben element thelbësor të nocionit të marrëveshjes.

Gjatë vitit 2013, institucioni i konkurrencës ka vazhduar shqyrtimi i rasteve të marrëveshjeve të ndaluara në bazë të ankesave apo nismës së Autoritetit për ndalimin e sjelljeve antikonkurrese në formën e ndarjes së tregut, fiksimit të çmimeve, kufizimit të tregut dhe/ose të prodhimit apo vendosjes së kushteve të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur disa palë në gjendje të pafavorshme konkurrence.

Me kalimin e viteve nga hyrja në fuqi e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” është rritur numri i ankesave për marrëveshje të ndaluara për shkak të rritjes së kulturës së konkurrencës kryesisht në bizneset dhe tregjet ku janë zhvilluar monitorime dhe hetime të Autoritetit të Konkurrencës. Por në të njëjtën kohë është rritur edhe shkalla e vështirësisë së gjetjes së evidencave direkte që do të provonin ekzistencën e marrëveshjeve të ndaluara.

Për këto arsye, Autoriteti i Konkurrencës është përqendruar në rritjen e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet zbatimit të teknikave bashkëkohore të evidentimit të marrëveshjeve të ndaluara dhe rritjes së kapaciteteve administrative për shqyrtimin e karteleve nëpërmjet analizave ekonomike dhe ekonometrike.

Procedurat kryesore hetimore për marrëveshjet e ndaluara kanë qenë si vijon:

II.2.1 Hetimi thelluar në tregun e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.

Sikurse është prezantuar gjatë raportimit të vitit 2012, bazuar në ankesat e ndërmarrjes “Alba Trans” dhe “Gerard A”, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 252, datë 26.11.2012 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës. Bazuar në evidencat e grumbulluara gjatë inspektimeve të realizuara në hetimin paraprak, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 262, datë 14.01.2013, vendosi hapjen e hetimit të thelluar në tregun e tregtimit të

biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas në qytetin e Tiranës ndaj ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg.

Evidencat e grumbulluara treguan se ndërmarrjet që vepronin në tregun objekt hetimi kishin kufizuar ndjeshëm tregtimin e abonesë së studentit. Në këto kushte, Komisioni i Konkurrencës, duke marrë në konsideratë rrezikun e kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, u shpreh me Vendimin nr. 263, datë 14.01.2013 “Për marrjen e masave të përkohshme për tregtimin e biletave të pajtimit mujor (aboneve) të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”. Masat e përkohshme kërkonin shpërndarjen dhe tregtimin e menjëhershëm dhe pa vonesë nga ndërmarrjet nën hetim të të gjithë sasisë së biletave të pajtimit mujor për nxënësit dhe studentët (abone studentit) sipas sasisë së përcaktuar nga Bashkia e Tiranës, duke filluar nga muaji Janar 2013.

Evidencat direkte të marra gjatë inspektimeve të njëkohshme në ndërmarrjet e transportit qytetas provuan kufizimin e konkurrencës nëpërmjet marrëveshjes së ndaluar midis ndërmarrjeve, pra, shkeljen e nenit 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si një shkelje e rëndë me pasoja për konkurrencën dhe konsumatorin. Ndërmarrjet “Ferlut” sha, “Tirana Lines” sha, “Alba Trans” ShPK, “Tirana Urban Trans” sha, “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” ShPK dhe “Otto-al” ShPK me anë të vendimeve të marra në Shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas (SHKTQ), kanë bërë një marrëveshje, si pasojë e së cilës kanë kufizuar tregtimin e 50% të sasisë së aboneve të studentit, për vitin 2007 dhe rreth 80% të sasisë së aboneve të studentit për periudhën 2008-2012. Nga evidencat konstatohet që ndërmarrja “Otto-al” ShPK nuk i ka zbatuar vendimet e SHKTQ-së si dhe ka dale nga tregu përkatës në muajin qershor 2012. Vendimet i anëtarëve të SHKTQ-së për të kufizuar sasinë e tregimit të biletave të pajtimit mujor (abone) studentit, përbëjnë evidenca direkte të një marrëveshje, si pasojë e së cilës është ulur pavarësia vendimmarrëse e palëve.

Palët nën hetim patën të drejtën të shprehin mbrojtjen e tyre në seancat dëgjimore të organizuara nga Komisioni i Konkurrencës që kryesisht lidheshin me mosplotësimin e kërkesave për subvencion nga ana e Bashkisë dhe problematika me abonentë e falsifikuara dhe pa dokumente shoqërues.

Në konkluzion, Komisioni i Konkurrencës me shumicë votash, u shpreh për marrjen e masës administrative, gjobë e rëndë (shuma totale 6.079.561 lekë) për shkelje të nenit 4 të Ligjit të Konkurrencës për ndërmarrjet “Ferlut” sha, “Tirana Lines” sha, “Alba Trans” ShPK, “Tirana Urban Trans” sha, dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve”. Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës ju drejtua me shkresa zyrtare Bashkisë Tiranë për adresimin për zgjidhje të problematikës së hasur në tregun e transportit qytetas për të miratuar një metodologji të qartë dhe transparente të ndarjes së aboneve sipas operatorëve dhe marrjen e masave për elementët shoqërues të biletës mujore të përgjithshme dhe asaj për studentët.

II.2.2. Hetimi i thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe me thasë

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë vitit 2013 vazhdoi procedurën e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të produktit çimento të tipit 42.5 rifuxho, të mbartur nga viti 2012. Me përfundimin e raportit të hetimit të thelluar, në vijim të procedurës, Komisioni i Konkurrencës organizoi seancat dëgjimore, në të cilat ndërmarrjet nën hetim paraqitën në mënyrë verbale edhe me shkrim pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar si dhe evidencat përkatëse.

Gjatë procedurave hetimore, nuk u gjetën evidenca direkte të bashkëpunimit midis firmave apo gjurmë komunikimi. Bazuar në evidencat e grumbulluara si dhe në faktet e paraqitura nga ndërmarrjet objekt hetimi gjatë seancave dëgjimore, rezultoi se rritja e çmimeve të shitjes nga prodhuesit dhe importuesit ka ardhur si rezultat i një sjellje dhe strategjie individuale konkurruese për t'ju përshtatur kushteve të tregut gjatë periudhës objekt hetimi, dhe nuk është shkaktuar nga një sjellje e bashkërenduar. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 291 , datë 23.07.2013 vendosi mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar ndaj ndërmarrjeve “Antea Cement” sha, “Fushe-Kruje Cement Factory”, ShPK, “Eurotech Cement” ShPK, “Elbasan Cement Factory” ShPK dhe “Colacem Albania” ShPK.

Për shkak të rëndësisë së këtij tregu, Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar ta mbajë nën monitorim tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos. Monitorimi po zhvillohet sipas të njëjtës metodologji që është përdorur edhe gjatë hetimit, me qëllim vlerësimin e sjelljes së 5 ndërmarrjeve më të mëdha të tregut të shitjes me shumicë të çimentos. Gjatë monitorimit po analizohen: struktura e tregjeve përkatëse dhe përcaktimi i treguesve të përqendrimit; analiza e çmimit të importit si dhe analiza e sjelljes së ndërmarrjeve kryesore në lidhje me ndikimin në ofertën në tregun e shumicës dhe dinamikës së çmimit të shitjes me shumicë.

II.2.3 Hetimi thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.

Sikurse është raportuar në vitin e kaluar, bazuar në një ankesë, Komisioni i Konkurrencës në fund të muajit Dhjetor 2012 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.

Në përfundim të hetimit paraprak rezultoi se në dokumentet e ndërmarrjeve të paraqitura në procedurat e prokurimit publik kishte shenja të bashkëpunimit, të cilat mund të përbënin kufizim të konkurrencës në kuptim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Komisioni i Konkurrencës bazuar në gjetjet e hetimit paraprak, të paraqitura edhe në raportin e hetimit, Vendimin nr. 257, datë 13.12.2012 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, ndaj ndërmarrjeve: “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k , “Nisa Security” Sh.p.k”, “Hoxha Security” Sh.p.k, “Hoxha” Sh.p.k dhe “Korça Security” Sh.p.k.

Autoriteti i Konkurrencës e trajtoi rastin nga mundësia e përdorimit të skemës së ofertës së mbuluar nga ndërmarrjet nën hetim, duke rënë dakord më përpara se cili do paraqesë ofertën fituese në procesin e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët. Sipas metodologjive të OECD-së dhe rasteve të ngjashme, ofertues janë vetëm ndërmarrjet pjesë e një grupi, si dhe ofertat e paraqitura janë shumë afër fondit limit dhe lëvizin shumë pak njëra nga tjetra, duke realizuar objektivin e realizimit të ofertës fituese dhe si rezultat dhe shumës që fituesi i ofertës do të marrë shumë afër me fondin limit të prokuruar.

Në vijim të procedurave, pas përfundimit të raportit të hetimit të thelluar, Komisioni i Konkurrencës, organizoi seancën dëgjimore me palët objekt hetimi duke u krijuar mundësinë e njohjes me raportin e hetimit të thelluar dhe me dosjen hetimore, si dhe mundësinë e paraqitjes së pretendimeve të tyre me shkrim dhe në mënyrë verbale para Komisionit.

Nga hetimi rezultoi se në shumicën e procedurave të prokurimit të realizuara, vërehet një pjesëmarrje e gjerë e të gjitha ndërmarrjeve nën hetim apo edhe ndërmarrjeve të tjera. Gjithashtu, vihet re edhe pjesëmarrje nga ndërmarrje me qendër në qarqe të tjera.

Si konkluzion, Komisioni i Konkurrencës evidentoi se janë gjetur prova komunikimi ndërmjet ndërmarrjeve nën hetim, por nuk provohet se ky komunikim ka çuar në një marrëveshje në oferta në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës për rastet e shqyrtuara, pasi fondi i prokuruar për rastet e hetuara kishte vlerat në intervalin nga 75% - 95% të fondit limit, pra nuk ishim ne kushtet e rasteve tipike me fond të prokuruar 99% të fondit limit.

Si përfundim, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 283, dt. 08.05.2013 vendosi mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, ndaj ndërmarrjeve: “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k, “Nisa Security” Sh.p.k, “Korça Security” Sh.p.k, “Hoxha” Sh.p.k dhe “Hoxha Security” Sh.p.k”.

II.2.4 Hetimi paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës.

Duke marrë shkas nga disa shqetësime të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi kufizimin e mundshëm të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës, Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me Vendimin nr. 274, datë 18.03.2013 për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën e hetimit nga janari deri në dhjetor 2012.

Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike u vlerësuan të dhënat e siguruara nga autoritetet kontraktore, pasi gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës nuk u gjet asnjë

evidencë që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit të realizuara në ndërmarrjet nën hetim dhe vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga autoritetet kontraktore përkatëse, rezultoi se nuk u gjetën evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës (për periudhën objekt hetimi), duke mos pasur në këtë mënyrë shenja të një kufizimi të mundshëm të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Si përfundim, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 287, datë 04.06.2013 vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës, pasi nuk kishte shenja të kufizimit të konkurrencës në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

II.2.5. Hetim i thelluar në tregun e importit/prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit lulediellit

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.249, date 09.11.2012, mbi "Hapjen e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit", ka hapur hetimin e thelluar për të parë nëse ka kufizime të konkurrencës në këtë treg". Rasti ka nisur pas një ankese nga një supermarket në lidhje me njoftimin për rritjen e çmimit të vajit vegjetal në mënyrë të menjëhershme nga disa ndërmarrje.

Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës kryen inspektime (Dawn Raids) në të njëjtën ditë dhe orë në të tre ndërmarrjet "Erbiron" Sh.pk, "Olim" Sha. dhe "Crystal" Sh.pk, për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve, por gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë prove apo evidencë direkte dhe indirekte. Në këto kushte, u përdorën teknikat e analizës ekonomike me qëllim evidentimin e sjelljes së mundshme të bashkërenduar mes konkurrentëve, për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të shitjes, kufizimin e ofertës, ritmet dhe masën e ndryshimit të çmimeve mesatare të shitjes me shumicë në raport me çmimet e blerjes në tregun ndërkombëtar, ndarja e tregjeve dhe burimeve të furnizimit. Për analizën e konkurrencës në tregun përkatës, Sekretariati ka kërkuar informacion nga këto ndërmarrje dhe ka bashkëpunuar me institucionet publike si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe INSTAT.

Nga analiza e trendit të ndjekur nga ndërmarrjet nën hetim rezultoi se: çmimet e shitjes me shumicë në disa raste, nuk kanë reflektuar në kohë uljet dhe kanë reaguar menjëherë ndaj rritjes së çmimeve të blerjes në tregjet ndërkombëtarë; ritmi i rritjes së çmimit të shitjes me shumicë për ndërmarrjet Olim, Erbiron janë më të larta se ritmet e rritjes së çmimit të blerjes në tregun ndërkombëtar; çmimet e shitjes me shumicë për ndërmarrjet Olim dhe Erbiron kanë të njëjtin trend.

Analiza nëpërmjet teknikës ekonometrike tregoi se ekzistonte një lidhje pozitive korreleuese midis çmimeve dhe se këto produkte janë zëvendësues të afërt. Nga kjo analizë rezulton se lidhja funksionale midis serive të çmimeve është lineare për çmimin e vajit Olim kundrejt çmimit me një ditë vonesë në kohë të çmimit të vajit të tregtuar nga ndërmarrja “Erbiron” sh.p.k dhe çmimit të vajit Crystal, gjatë periudhës objekt hetimi Janar- Tetor 2012. Pra, ndërmarrjet nën hetim “Erbiron” sh.p.k dhe “Olim” shfaqin tendenca të përafërta të rritjes së çmimit, të cilat tregojnë një nivel të ulët të konkurrencës në tregun përkatës, por që nuk përbën një evidencë të mjaftueshme për të provuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar në kuptim të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Raporti i hetimit të thelluar iu dërgua palëve në hetim duke i vënë në dispozicion edhe dosjen hetimore për konsultim. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit me datë 09.04.2013 është organizuar seanca dëgjimore me palët nën hetim përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 284, datë 13.05.2013 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit ndaj ndërmarrjeve “Erbiron” sh.p.k”, “Olim” Sh.a dhe “Crystal” sh.p.k., Komisioni Konkurrencës u shpreh se: ndërmarrjet nën hetim, “Erbiron” sh.p.k dhe “Olim” Sh.a gjatë periudhës objekt hetimi shfaqin tendenca të përafërta të rritjes së çmimit, të cilat tregojnë një nivel të ulët të konkurrencës në tregun përkatës, por që nuk përbën një evidencë të mjaftueshme për të provuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar në kuptim të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me këtë vendim është ngarkuar Sekretariati të vazhdojë monitorimin e tregut të prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të vajit të lulediellit, pasi gjatë hetimit ndërmarrjet kanë patur tendenca të përafërta të rritjes së çmimit.

II.2.6. Hetim paraprak në tregun e sigurimeve

Tregu i sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit ka qenë objekt i vazhdueshëm monitorimi dhe hetimi për kufizime të konkurrencës në treg, ku ka patur sanksione ndaj ndërmarrjeve që kanë shkelur Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe janë dhënë rekomandime për rritjen e konkurrencës në treg.

Bazuar në disa sinjale të marra nga operatorët e tregut të sigurimeve, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, me kërkesën e Komisionit të Konkurrencës, ka monitoruar tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve e treta. Nga monitorimi rezultoi se nga data 1 Nëntor 2013 të gjithë agjentët e shitjes i tregtonin këto polica nëpërmjet një sistemi që quhej MSHM dhe menaxhohej nga një broker. Të dhënat e sistemit të një agjenti në një moment të caktuar nuk të ofronin të gjitha kompanitë e licencuara për tregtimin e produktit përkatës, por një numër më të kufizuar mesatarisht 4-5 shoqëri. Ndërkohë që nuk është e qartë numri dhe mënyra e shfaqjes së kompanive të disponueshme për lëshimin e policave të sigurimit, pasi në një tjetër agjent, sipas deklarimeve të tij shfaqeshin të gjitha shoqëritë e sigurimeve. Bazuar në gjetjet, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 297, datë 18.11.2013 ka hapur procedurën e hetimit paraprak në tregun e policës së sigurimit për mjetet e transportit për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta.

Sekretariati ka realizuar procedurat hetimore në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, “Kodin e procedurave” dhe “Rregulloren e procedurave investigative”. Në vijim të procedurave, u identifikuan shqetësime të tjera në treg, për rrjedhojë Komisioni i Konkurrencës në shkurt 2014 vendosi për zgjatjen e periudhës objekt hetimi në këtë treg, për një hetim sa më të plotë të këtij tregu. Hetimi është në proces.

II.3 Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve

Komisioni i Konkurrencës gjatë vitit 2013 ka analizuar vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve”

Objekti i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit për produktin MTPL e brendshme të mjeteve motorike lidhur me vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve; vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta; mbulimi i zakonshëm për disa lloje të caktuara rreziqesh; shlyerja e dëmeve; testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë; regjistrat dhe informacioni mbi rreziqet e rënda.

Palët pjesëmarrëse në marrëveshje shprehen se janë të ndërgjegjësuar për zbatimin e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke shprehur angazhimin se nuk do të realizojnë kufizime që bien ndesh me nenin 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si ndarje tregu apo fiksimit çmimi, por do ta mbështesin aktivitetin e tyre tregtar vetëm në kuadrin ligjor dhe nënligjor që mundëson bashkëpunimin me qëllim arritjen e standarteve të sistemit financiar të sigurimeve.

Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 298, datë 06.11.2013 “Marrëveshja e bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, për nga objekti dhe qëllimi është në përputhje me nenin 3 të Rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve” dhe plotëson kushtet për të përfituar nga përjashtimi i ndalimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Komisioni i Konkurrencës e miratoi këtë marrëveshje duke kërkuar angazhime nga palët e përfshira të cilat konsistojnë në: tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm me logot respektive; tek pjesa e “Detyrimeve të palëve” duhet të shtohet se palët kanë detyrimin të mos japin asnjë informacion në lidhje me çmimin e policës së sigurimit, nivelin e fitimeve, kostot apo çdo element tjetër që ndikojnë në përcaktimin e çmimit fundor të policës së sigurimit, si dhe çdo informacion tjetër që mund të dëmtojë konkurrencën në treg; afati i vlefshmërisë së kësaj marrëveshje u përcaktua 1 vit.

II.4 Abuzimi me pozitën dominuese

Pozita dominuese i referohet pozitës që zotërohet në një treg përkatës nga një ndërmarrje e cila i mundëson kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës efektive në

këtë treg. Kriteret për vlerësimin e pozitës dominuese jepen në nenin 8 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Analiza dhe vlerësimi i pozitës dominuese fillon me përcaktimin e tregut përkatës, për të cilën llogariten pjesët e tregut që zotëron ndërmarrja. Pozitë dominuese është ajo që zotërohet nga një ose më shumë ndërmarrje, dhe që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i përket ofertës apo kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg. Në analizë merret edhe fuqia e konkurrentëve të tjerë që veprojnë në treg, e blerësve si dhe barrierat ligjore dhe ekonomike për hyrësit e rinj në treg. Një ndërmarrje mund të zotërojë një pozitë dominuese individualisht, por dy ose më shumë ndërmarrje mund të zotërojnë një pozitë dominuese të përbashkët.

Sipas parimit të ligjit antitrust nuk ndalohet pozita dominuese por abuzimi me këtë pozitë dominuese. Në bazë të nenit 9 të Ligjit ndalohet çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese, të cilat mund të jenë në formën e çmimeve të larta dhe të padrejta, çmimeve apo kushteve diskriminuese, refuzim të ofrimit të shërbimit, etj.

Gjatë viti 2013 janë përfunduar çështjet e mbaruara nga viti 2012 si dhe janë trajtuar raste të reja të nisura mbi bazën e ankesave të depozituara tek Autoriteti i Konkurrencës.

II.4.1. procedurat hetimore (Hetim paraprak dhe i thelluar) në tregun e telefonisë celulare me pakice

Sikurse është raportuar vitin e kaluar, pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozituan 2 (dy) ankesa nga ndërmarrjet “Plus Communication” sha dhe “Albanian Mobile Communication” sha, ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” sha me pretendimin se ka abuzuar me pozitën dominuese në tregun e telefonisë celulare. Gjithashtu, ky shqetësim ishte prezantuar edhe nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në raportin: “Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/orijjinimit dokumenti përfundimtar”.

Bazuar në këto shqetësime mbi nivelin e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare, Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me anë të Vendimit nr. 261, datë 11.01.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

Nga hetimi paraprak, rezultoi se ndërmarrja Vodafone, e cila ushtron veprimtari në tregun e telefonisë celulare, zotëronte pozicionin dominues në tregun me pakicë dhe se ekzistonin shenja të abuzimit të mundshëm me pozitën e saj dominuese në treg. Bazuar në gjetjet e hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, u shpreh me anë të Vendimit nr.275, datë 25.03.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, ndryshuar me Vendimin nr. 280, datë 22.04.2013, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 275, datë 25.03.2013, për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, vendosi hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA.

Gjatë procesit, ndërmarrja objekt hetimi kërkoi revokimin e vendimit për hapje të hetimit të thelluar, për të cilën Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin nr. 285, datë 20.05.2013, sipas të cilit revokimi i vendimeve të këtij Komisioni mund të bëhet vetëm nëse plotësohen disa kritere të caktuara me ligj, dhe nga vlerësimi i kërkesës paraqitur nga Vodafone dhe i argumenteve përkatëse rezulton se këto kritere nuk

plotësohen. Prandaj u vendos lënia në fuqi e vendimit të mëparshëm dhe vazhdimi i procedurave të hetimit të thelluar.

Në vijim të procedurës, Sekretariati i paraqiti Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë. Ky raport iu bë me dije dhe ndërmarrjes nën hetim.

Nga analizat e kryera rezulton se ndërmarrja “Vodafone Albania” ka pozitë dominuese në tregun e telefonisë celulare me pakicë, sipas treguesit të të ardhurave dhe numrit të kartave SIM aktive. Gjithashtu, për përcaktimin e pozitës dominuese u analizuan jo vetëm pjesët e tregut, por edhe fuqia e tregut, pengesat në hyrje, konkurrencën potenciale, fuqinë ekonomike dhe financiare të konkurrentëve, fuqinë kundërvepruese të konsumatorëve dhe blerësve, konkurrentëve si dhe karakteristika të tjera të tregut me pakicë për vitet 2011-2012.

Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes objekt hetimi, gjatë periudhës nën hetim kryesisht në sjelljen e saj ndaj çmimit dhe ndaj konkurrentëve në tregun përkatës, në lidhje me planet tarifore Vodafone Card dhe Vodafone Club që kjo ndërmarrje ofron, ofertat ditore, javore dhe mujore, ofertat që lidhen me tërheqjen e abonentëve të rinj nëpërmjet portabilitetit të numrit dhe bonuset e ofruara ndaj distributorëve.

Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes objekt hetimi rezultoi se strategjia e ndjekur nga ky operator shkakton shqetësime për konkurrencën në tregun përkatës si dhe efekte negative për konkurrencën në periudha afatgjata ndaj konkurrentëve më të vegjël, nëpërmjet aplikimit të diferencimit të çmimit të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit (on-net vs off-net). Analiza e rasteve të ngjashme tregon se diferencimi i çmimeve brenda me jashtë rrjetit mund të përdoret si një mekanizëm i mbylljes së tregut nga operatorët e mëdhenj për operatorët e vegjël të cilët mund të rrezikojnë daljen nga tregu përkatës, dhe ky fakt përbën një shqetësim për mirë funksionimin e tregut në një periudhë afatgjatë.

Ndërmarrja Vodafone është angazhuar publikisht që të barazojë tarifat brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt nr. fiks, AMC, Eagle dhe Plus) për të ulur drejt eliminimit diferencimin e tarifave të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit.

Në fillim të vitit 2014, pas shqyrtimit të raportit dhe dëgjimit të palës në hetim, Komisioni i Konkurrencës konkludoi se kjo sjellje e Vodafone Albania nuk përbën abuzim me pozitën dominuese gjatë periudhës në hetim, por strategjia e ndjekur nga ndërmarrja sjell shqetësim për konkurrencën në periudhën afatgjatë, prandaj i adresoi disa rekomandime rregullatorit të tregut. Me konkretisht:

Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të marrë masat e ndërmjetme dhe të menjëhershme, përpara përfundimit të analizës së tregut të pakicës së telefonisë celulare, për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut për të parandaluar daljet nga tregu që do kishin pasoja afatgjatë mbi konkurrencën, dhe në veçanti: të modifikojë modelin BULRAIC duke ulur ndjeshëm koston e terminimit për operatorët e vegjël ndaj operatorëve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës; të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave off-net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese.

Gjithashtu Komisioni i Konkurrencës i rekomandoi AKEP të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatorë

për reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifë jashtë rrjetit të operatorit Vodafone si dhe të monitorojë zbatimin e angazhimit publik të Vodafone Albania për barazimin e tarifave brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt fiks, AMC, Eagle dhe Plus) dhe në veçanti, reflektimin e zvogëlimit real të kësaj difference jo vetëm në tarifën nominale (off-net, on-net), por edhe në njësitë e përfshira në paketat opsionale të komunikimit kombëtar (ofertat dhe paketat javore, mujore e vjetore)

II.4.2 Hetimi paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”.

Bazuar në një ankesë të adresuar nga një operator në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të gazit të lëngshëm të naftës (GLN), Komisioni i Konkurrencës u shpreh me anë të Vendimit nr. 277, datë 03.04.2013, për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të GLN-së në zonën Porto Romano për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës nga ndërmarrja që zotëron konçesionin e pontilit të ngarkim-shkarkimit në këtë port.

Bazuar në të gjitha faktet dhe evidencat e grumbulluara gjatë procesit të hetimit paraprak në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare në Porto Romano, mbi të gjitha praktikën e ngarkim-shkarkimit të realizuar nga ana e “Romano Port” SHA për periudhën hetimore, si dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese “Romano Port” SHA, rezultoi se nuk kishte evidencë të abuzimit me pozitën dominuese nga ana e ndërmarrjes Romano Port SHA, të parashikuara në nenin 9, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Si përfundim, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 289, datë 4.07.2013 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano” pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

II.4.3 Hetimi paraprak në tregun e importit prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve.

Bazuar në disa shqetësime publike mbi nivelin e konkurrencës në tregun e importit dhe të tregtimit me shumicë të hidrokarbureve, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës realizoi një monitorim në këtë treg, nga i cili rezultoi ndryshime të ndjeshme në strukturat e tregut dhe rritjen e shkallës së përqendrimit. Bazuar në gjetjet e monitorimit dhe me propozim të Sekretariatit, Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr. 292, datë 16.09.2013, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës. Periudha objekt hetimi ishte përcaktuar janar 2010 deri në gusht 2013.

Për një analizë sa më objektive të sjelljes së operatorëve të tregut, Komisioni ka vendosur zgjatjen e periudhës hetimore për të parë sjelljen e ndërmarrjeve pas daljes nga tregu i importit të ndërmarrjes Taçi Oil SHA në muajin prill 2013, si dhe sjelljen e këtyre ndërmarrjeve pas ndryshimeve fiskale të pritshme për vitin 2014.

II.5. Kontrolli i përqëndrimeve

Kontrolli i përqëndrimeve është një nga instrumentet ligjorë që i mundësojnë Autoritetit të Konkurrencës të parandalojë forcimin apo rritjen e përqëndrimit në treg, duke i dhënë të drejtën të mos autorizojë apo të autorizojë me kushte realizimin e transaksioneve të shit/blerjes së aksioneve midis ndërmarrjeve, nëse këto transaksione shkaktojnë forcimin e ndjeshëm të përqëndrimit në tregun përkatës, apo kufizimin e konkurrencës efektive në treg. Neni 13 i Ligjit ndalon bashkimet, të cilat rrezikojnë të krijojnë ose forcojnë një pozitë dominuese. Kjo do të thotë që duhet të ketë një lidhje shkakësore ndërmjet bashkimit dhe pozitës dominuese që mund të krijohet. Kjo lidhje sigurisht që mungon në rastin kur bashkimi i ndërmarrjeve ndodh me qëllim eliminimit të një ndërmarrjeje të caktuar. Në këtë rast lejohet dhe autorizohet përqëndrimi dhe/ose bashkimi.

Gjatë vitit 2013, është vënë re rritja e numrit të përqëndrimeve të njoftuara pranë Autoritetit për marrjen e autorizimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e uljes së pragut të xhiros së ndërmarrjeve objekt përqëndrimi që kanë detyrimin ligjor për marrjen e autorizimit të Komisionit të Konkurrencës. Ndërkohë në kuadër të mbikëqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës pasi ka administruar të gjithë databasen nga Qendra Kombëtare të Regjistrimit, ka filluar me nismën e tij procedurat për njoftimin e të gjitha rasteve që përmbushin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, por që nuk janë njoftuar nga palët.

II.5.1 Përqëndrimet e autorizuara

Gjatë vitit 2013, janë shqyrtuar dhe autorizuar 13 praktika përqëndrimesh lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrjeje të re. Përqëndrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqëndruar në treg.

i. Bashkim i dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra.

Nga përqëndrimet e autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës asnjë rast nuk ka rezultuar të jetë bashkim apo shkrirje i/e dy ndërmarrjeve.

ii. Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i një ose më shumë ndërmarrjeve ose të një pjese të kësaj të fundit.

Në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 266, datë 05.02.2013, autorizoi përqëndrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë 'Vil Oil' SHA nga shoqëria "City Investment Holding" SHA tek aksionaret Z.A.G dhe Z.A. A, pasi nuk krijonte apo forconte pozitën dominuese në tregun përkatës të produktit. Kjo ka qenë e vetmja procedurë kontrolli që është hapur nga Autoriteti i Konkurrencës me nismën e tij gjatë vitit 2012 dhe që ka vazhduar deri në shkurt të vitit 2013. Në këtë rast Autoriteti i Konkurrencës ka gjobitur me 100 mijë lekë shoqërinë "Vil Oil" SHA për

mosnjoftim të përqendrimit me Vendim nr.265 , datë 05.02. 2013, pasi mosnjoftimi përbën shkelje të lehtë në bazë të nenit 73 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në tregun e nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe prodhimit të ferrokromit, gjatë vitit 2013, Komisioni i Konkurrencës me shumicë votash, ka autorizuar përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të “Albanian Chrome” Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga “DCM DECO metal GmbH” dhe “DCM Beteiligungs GmbH” tek “Balfin’ Sh.p.k me anë të Vendimit nr.264, datë 05.02.2013 . Pasi u bë analiza e konkurrencës, u konkludua se palët në transaksion vepronin në tregje përkatëse të ndryshme, pra nuk kishte tregje të prekura dhe për pasojë struktura e tregut pas përqendrimit nuk ndryshonte.

Në tregun ajror. Përqendrimi ndërmjet shoqërive “Olimpic Air’ S.A. dhe “Aegean Airlines’ S.A. e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë “Olimpic Air” S.A. nga shoqëria “Aegean Airlines” S.A., nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të saj nga ‘Marfin Investment Group’ S.A, i cila ka ndodhur në tregun grek të aviacionit, ka pasur pasoja edhe në tregun shqiptar përsa i përket shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve në linjën Tiranë – Athinë. Ky përqendrim është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.267, datë 05.02.2013. Gjithashtu ky përqendrim është autorizuar edhe nga Komisioni Europian.

Në tregun e shitjes me pakicë, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 268, datë 08.02.2013, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë “Delhaize Albania’ Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga “Lion Retail Holding” s.a.r.l dhe ‘Delhaize Serbia’ d.o.o te “Balfin” Sh.p.k. Ky përqendrim ka ndodhur në tregun me pakicë i produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit.

Pas transaksionit të mësipërm, shoqëria ‘Balfin Group” vendosi të transferojë biznesin e “Euromax” tek shoqëria franceze me eksperiencë në tregun me pakicë të produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit. Komisioni i Konkurrencës (me shumicë votash), me Vendimin e tij nr. 279, date 22.04.2013, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ‘Euromax” Sh.p.k, nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Gjithashtu një përqendrim tjetër i cili ka ndodhur jashtë kufijve të Shqipërisë, por që ka pasur ndikim në tregun e brendshëm të **përpunimit dhe prodhimit të duhanit,** ka qenë edhe përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria “Japan Tobacco International Netherlands” B.V të shoqërisë “Nefftekx World II” B.V, nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Batata S.A”. ky përqendrim është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 271, datë 26.02.2013, pasi nga përqendrimi nuk do rezultojnë efekte negative për konkurrencën.

Në tregun e kozmetikës është njoftuar përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëritë “Bregal Fund III” LP dhe “Quadriga Capital Private Equity Fund IV” LP të shoqërisë “LR Global Holding” GmbH. Komisioni i Konkurrencës e autorizoi edhe këtë përqendrim me Vendimin nr. 272, datë 26.02.2013.

Gjatë vitit 2013, është njoftuar vetëm një përqendrim në **tregun e ndërtimit**. Përqendrimi është realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë “Investndërtim Tirana” Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga “GPL Construzioni Generali” S.r.l tek Investment “Joti- Infosoft Group” Sh.p.k dhe është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij nr. 278, date 15.04.2013 . Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, pasi ndërmarrjet e përfshira veprojnë kryesisht në tregje produkti të ndryshme.

Në kuadër të privatizimit, në **tregun e energjisë elektrike**, Qeveria ka realizuar privatizimin e hidrocentraleve Hec “Bistrica 1 Bistrica 2 Sh.a në mbështetje të Ligjit 93/2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 % të aksioneve të shoqërisë Hec Bistrica 1 Bistrica 2 Sh.a, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe shoqërisë Kurum International Sh.a”, të datës 11 shkurt 2013. Ky transaksion i realizuar nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria “Kurum International” SHA përbën një përqendrim dhe është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, me shumicë votash, me Vendimin nr. 282, date 30.04.2013.

Gjithashtu, edhe **HEC Ulëz-Shkopet** është privatizuar në mbështetje të Ligjit 94/2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 % të aksioneve të shoqërisë Hec Ulëz Shkopet SHA, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe shoqërisë Kurum International Sh.a”, të datës 11 shkurt 2013. Edhe ky përqendrim është realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të HEC Ulëz-Shkopet nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria “Kurum International” SHA, është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, me shumicë votash, me Vendim nr. 281, datë 30.04.2013.

Në tregun e transportit ndërkombëtar, konçesionari i “Aeroportit Internacional të Tiranës” (TIA) ka vendosur të transferojë aksionet e tij një Fondi Kanadez. Përqendrimi, i cili është realizuar në tregun e shërbimeve e infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore është realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit indirekt të ‘Tirana International Airport’ Sh.p.k and “Hochtief Airport Retail” Sh.p.k nga ‘Public Sector Pension Investment Board’, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë ‘Hochtief Airport’ GmbH. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për pasojë është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr.288, datë 25.06.2013.

Në tregun e shërbimeve e internetit dhe të telefonisë fikse, gjatë vitit 2013, është realizuar një përqendrim nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria “AD-Trade” te shoqërisë ‘Primo Communications’ sh.p.k. nëpërmjet përfutimit të 100% të kuotave të saj nga Telekom Slovenia. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.294, datë 28.10.2013, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të

kontrollit. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Në tregun e lojërave të fatit dhe kazino elektronike është njoftuar përqendrimi që ka ndodhur në shoqërinë “Europa Kazino 2009” SHA. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 299, datë 06.12.2013, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë “Europa Kazino 2009”SHA. nga Z. E. P, pasi ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

iii. **Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, që kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur – (Joint Venture)**

Nga përqendrimet e autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës, gjatë vitit 2013, nuk rezultoi asnjë ndryshim të qëndrueshëm kontrolli që vinte si pasojë e krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët (*joint venture*), e cila kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur.

II.5.2 Raste të shqyrtuara që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në kuadër të nenit 6 të “Rregullores për zbatimin e procedurave të përqendrimin të ndërmarrjeve”, gjatë vitit 2013, pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur 1 rast transaksioni, i cili nuk është konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Transaksioni i njoftuar ka pasur si objekt realizimin e përfundimit të kontrollit të shoqërisë “Slovene Mercator” d.d nga shoqëria kroate “Agrokor” d.d.. Palët, për këtë qëllim, kanë nënshkruar Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve në “Poslovni Sistem Mercator” d.d ndërmjet aksionerëve të maxhorancës (si shitës) dhe “Agrokor” d.d (si blerës), më datë 14 qershor 2013. Pas realizimit të këtij transaksioni, Grupi Mercator do të kontrollohet tërësisht nga shoqëria “Agrokor” d.d, e cila e sheh këtë transaksion si një mundësi të mirë investimi. Pas realizimit të transaksionit shoqëria “Mercator” d.d kontrollohet nga shoqëria “Agrokor” d.d, i cili në bazë të nenit 10 pika 1 shkronja a) e Ligjit, përbën një përqendrim. Gjithashtu, në bazë të të dhënave financiare të vëna në dispozicion nga përfaqësuesi ligjor, shoqëritë pjesëmarrëse në këtë transaksion përmbushin edhe kushtin e xhirove për vitin financiar 2012. Por, meqenëse transaksioni i përfundimit të kontrollit të shoqërisë Mercator d.d (Slloveni) nga shoqëria Agrokor d.d (Kroaci) përbën një përqendrim, i cili ndodh jashtë tregut të Republikës së Shqipërisë. Ky përqendrim nuk ka pasur ndikim në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë, në tregun e brendshëm dhe për pasojë, në bazë të nenit 56 të Ligjit nr.9121, nuk ishte objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni i Konkurrencës.

II.6 Monitorimet e tregut

Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të detyrave të përcaktuara në vendimet e Komisionit të Konkurrencës për monitorimet e tregjeve për të cilat janë ndërmarrë procedura hetimore, apo për hulumtimin e tregjeve me nivel të konsideruar përqendrimi, realizon

monitorime të cilat janë objekt i punës, kryesisht i Sektorit të kërkimit dhe analizës së tregut.

II.6.1. Monitorimi i tregut të transportit ajror

Gjate gjysmës së parë të vitit 2013, përfundoi procesi i monitorimit të tregut të transportit ajror të pasagjereve dhe raporti përkatës u dërgua për mendim pranë Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Organit Shtetëror të Autorizuar, si dhe u organizuan takime në nivel ekspertësh me institucionet respektive, opinionet e të cilëve u reflektuan në raport.

Konkluzionet kryesore të raportit janë:

- Tregu i transportit ajror të pasagjerëve është i përbërë nga dy shërbime bazë të cilat janë plotësues të njëri tjetrit: shërbimi i ofruar nga aeroporti ose shërbimet aeroportuale dhe shërbimet e ofruara nga kompanitë ajrore, të cilat realizojnë lëvizjen e udhëtarëve. Këto shërbime rregullohen nga entet rregullatorë sipas specifikave dhe detyrave përkatëse.
- Shërbimet aeroportuale ofrohen për shoqëritë ajrore vetëm nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, kështu që TIA është i vetmi operator në tregun e shërbimeve aeroportuale, pra ka pozitë dominuese në këtë treg, dhe kompanitë ajrore nuk kanë mundësi tjetër zgjedhjeje për të përfituar këtë shërbim. Kompanitë “low cost” të njohura për ofrimin e shërbimeve me kosto të ulët nuk mund të hyjnë në tregun e fluturimeve në Shqipëri, pasi nuk mundësohet ofrimi i shërbimit aeroportual nga një aeroport dytësor apo me kosto të ulët.
- Tarifat e aeroportit “Nënë Tereza” kanë ndryshuar për herë të fundit në vitin 2007, sipas ligjit të konçesionit tarifat duhet të ndryshojnë çdo tre vjet, pra ka kaluar afati i ndryshimit apo rishikimit të tarifave që duhet të kryhej në vitin 2010 dhe 2013.
- Për tarifat që aplikon aeroporti nuk ka një metodologji apo rregullore të aprovuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar. Tregu i shërbimeve aeroportuale është me një operator të vetëm, në kushtet e mungesës së konkurrentëve duhet që rregullatori të ndikojë në rregullimin e tarifave duke i orientuar ato drejt kostos, me qëllim që të parandalohet abuzimi me pozitën dominuese në treg.

II.6.2. Monitorimi i tregut të energjisë.

Gjate vitit 2013, është zhvilluar monitorimi i tregut të energjisë elektrike, i cili iu dërgua për mendim edhe Entit Rregullator të Energjisë. Në raport janë përfshirë zbatimi i rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës për tregun e energjisë elektrike, opinionet e aktorëve të ndryshëm të tregut si Shoqata e Furnizuesve me Energji Elektrike, vlerësimet e Sekretariatit të Energjisë rreth tregut të energjisë elektrike në Shqipëri etj. Mendojmë që për sqarim të mëtejshëm të situatës së tregut të energjisë elektrike të organizohet një takim midis dy institucioneve tona në nivel bordi vendimmarrës.

II.6.3. Monitorimi i tregut të hidrokarbureve (karburante dhe gaz i lëngshëm)

Nisur nga ndjeshmëria e lartë që paraqesin karburantet në zhvillimin ekonomik dhe në shpenzimet konsumatore, tregu i karburanteve është bërë pjesë e monitorimeve të vazhdueshme gjatë vitit 2013. Qëllimi i monitorimit ishte evidentimi i ndryshimeve në strukturën e tregut të karburanteve (dizel 10ppm dhe benzinë), ecuria e çmimeve në treg për të parë nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e mundësisë së koordinimit të sjelljes në treg dhe/ose abuzimit me pozitën dominuese (në rast të ekzistencës) të një ose disa (dominancë kolektive) ndërmarrjeve aktive në tregun përkatës.

Metodologjia e monitorimit konsistonte në vlerësimin e treguesve të përqendrimit, vlerësimin e dinamikës së çmimit të importit dhe shitjes me shumicë si dhe vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve të mëdha në lidhje me çmimet e shitjes. Rritja e shkallës së përqendrimit të tregut, trendi i njëjtë i çmimit të shitjes së dieselit dhe benzinës në stacionet e shitjes me pakicë të ndërmarrjeve të lidhura me ndërmarrjet importuese (të cilat pasqyrojnë politikat e çmimeve që ndjekin ndërmarrjet importuese), kanë qenë elementet kryesorë që mbështetën propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm për hapjen e hetimit paraprak në tregun e karburanteve për shkelje të mundshme të nenit 4 dhe 9 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës". Ky treg është në procedurë hetimore.

II.6.4. Tregu i importit dhe tregtimit më shumicë të gazit të lëngshëm.

Monitorimi i tregut të importit dhe tregtimit më shumicë të gazit të lëngshëm ka qenë një procedurë e cila ka disa vite që është pjesë e punës së Sekretariatit. Nga analiza e indikatorëve të konkurrencës për tregun e importit të gazit për vitin 2012 rezultoi se:

- Struktura e tregut të gazit, paraqet ndryshime të rëndësishme pasqyruar në sigurimin e ofertës së lartë të gazit të importuar nga një ndërmarrje e vetme. Ndërmarrja kryesore zotëron 53% të tregut të importit, pjesë kjo më e madhe se e tre ndërmarrjeve e tjera në radhë duke e klasifikuar si ndërmarrje më pozitive dominuese në treg. Ndërmarrjet e tjera në treg pasqyrojnë ndryshime të theksuara të pjesëve që zotërojnë në treg, gjë e cila tregon për një konkurrencë të fortë mes tyre.
- Rezulton ulje e numrit të ndërmarrjeve importuese, konkretisht gjatë vitit 2012 kanë realizuar importin e gazit të lëngët 13 ndërmarrje nga 19 që kanë operuar gjatë 2011.
- Nga analiza e treguesve të çmimit rezultoi se çmimi i shitjes me shumicë të gazit nga 4 ndërmarrjet me të mëdha në tregun e importit të tij, ndjek trendin e çmimit mesatar mujor të blerjes së gazit. Nuk ka çmime të njëjta të shitjes së gazit nga ndërmarrjet e analizuarat. Në çmimin e shitjes më pakice nuk janë reflektuar uljet e konstatuara në çmimin e blerjes së gazit të lëngshëm.
- Zhvlerësimi i monedhës vendase ndaj asaj amerikane ka sjellë një efekt rritës në masën 3.8% të çmimit.

Për sa më sipër, është menduar që monitorimi në vazhdim i tregut të gazit të fokusohet në vlerësimin e strukturave të ndërmjetme të shitjes së gazit, të cilat nuk kanë qenë pjesë e monitorimeve të deritanishme. Analiza e kësaj strukture ka hasur në vështirë për shkak të mungesës së të dhënave të sakta. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është kërkuar lista e subjekteve të cilat operojnë në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm, por nga databaza e DPT, subjektet që shesin gaz të lëngshëm kodifikohen me të njëjtin kod si të gjitha subjektet që shesin karburante dhe lëndë djegëse duke na krijuar vështirësi në evidentimin e ndërmarrjeve objekt monitorimi.

II.6.5. Monitorimin i tregut financiar kryesisht të marrëveshjeve mes bankave dhe shoqërive të sigurimit.

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në disa shqetësime të përcjella nga konsumatori, realizoi monitorimin në tregun financiar në lidhje me marrëdhënien midis bankave dhe shoqërive të sigurimit. Qëllimi i këtij monitorimi ishte vlerësimi i sjelljes së bankave dhe shoqërive të sigurimit në lidhje me marrëveshjet mes tyre për policat e sigurimit të jetës dhe kolateralit, të cilat mund të sjellin prishjen apo shtrembërim të konkurrencës në treg.

Vlerësimi i sjelljes së bankave dhe shoqërive të sigurimit u realizua mbi bazën e analizës së:

të drejtave dhe detyrimeve të palëve që përshkruhen në kontratat mes bankave dhe shoqërive të sigurimit për sigurim kolateralit dhe jete; analizës së strukturës së tregut të kredive dhe të sigurimit të kolateralit dhe jetës nga shoqëritë e sigurimeve; vlerësimin e përfitimeve të bankave nga shoqëritë e sigurimeve dhe përcaktimin e strukturës së tregut mbi bazën e të ardhurave nga komisionet e shërbimeve për sigurimin e kolateralit dhe jetës. Gjithashtu, u tërhoqën opinionet nga persona që kanë marrëdhënie me bankat ose shoqëritë e sigurimit.

Nisur nga analiza e tregut përkatës, rezultoi se tregu i produktit ishte specifik për çdo bankë që ofronte shërbimin e kredive me kolateral dhe analiza e konkurrencës u vlerësua në marrëdhëniet e çdo banke me shoqëritë e sigurimit. Analiza u fokusua në faktin nëse bankat kufizojnë ose jo kredimarrësit në zgjedhjen e shoqërive të sigurimit të kolateralit dhe jetës dhe nëse bankat janë transparente dhe japin informacionin e mjaftueshëm që kredimarrësit të bëjnë zgjedhjen e duhur.

Nga analiza e sjelljes së secilës bankë ndaj kredimarrësve në rolin e ndërmjetësit në përfitimin e kontratës së sigurimit të pronës dhe jetës u konstatua se:

- Të gjitha bankat e kanë të përcaktuar në kontratat e kredive detyrimin e kredimarrësit për sigurimin e kolateralit dhe jetës për gjithë periudhën e shlyerjes së kredisë.
- Në kontratat e lidhura vihet re se kredimarrësi është i detyruar të mbajë të njëjtën kompani sigurimi për gjithë periudhën e shlyerjes së kredisë. Pothuajse në të gjitha kontratat është përcaktuar miratimi paraprak i bankës për kompaninë e sigurimit që do të zgjedhë kredimarrësi. Për një funksionim efikas të këtij tregu është e nevojshme që klientët të kenë mundësinë të rishikojnë vendimet e tyre të mëparshme dhe të përzgjedhin produktin që është më i mirë për ta. Në situata të tilla kompanitë e sigurimeve konkurrojnë vetëm kur është nënshkruar kontrata dhe përfitimet e konkurrencës mund të zhduket me ndryshimet e situatës së tregut dhe rrethanave.
- Në një rast u identifikua se përdorej standart i dyfishtë ndaj klientëve duke qenë më dominues dhe kufizues ndaj kredimarrësve individualë në zgjedhjen e kompanive të sigurimit kundrejt klientëve të mëdhenj (korporatave dhe SME). Kjo sjellje tregon mungesë transparence ndaj një kategorie klientësh me vulnerabël me qëllim përfitimin e të ardhurave nga komisioni i shërbimit dhe i pjesëmarrjes në fitim nga ana e sigurvecit. Sipas të dhënave nga banka, nga kategoria “Individëve” dhe “Micro” banka siguron rreth 40% të të ardhurave nga komisioni i shërbimit si ndërmjetës në lidhjen e kontratat e sigurimit dhe të gjitha kontratat janë të lidhura vetëm me një kompani sigurimi.
- Në kontratat e lidhura mes kompanive të sigurimit dhe bankave, bankat trajtohen si agjentë dhe për shërbimin e kryer përfitojnë komisione shërbimi nga kompanitë e sigurimit. Fakti që bankat gjenerojnë të ardhura nga shërbimi i ndërmjetësimit në kontratat e sigurimit të kolateralit dhe jetës mund të jetë arsye e mjaftueshme që bankat të orientojnë klientët kredimarrës drejt kompanive të sigurimit nga të cilat banka përfitojnë komisionin më të lartë të shërbimit. Është vënë re se bankat kryesore në tregun e kredidhënies kanë dhe vlerën më të lartë të përqindjes së komisionit të shërbimit të lidhjes së kontratave të sigurimit, ku ky komision shkon në 24% të primit.
- Nga informacioni i ardhur nga AMF-ja u konstatua së bankat e nivelit të dytë nuk janë të licencuara për ushtrimin e aktivitetit të brokerimit, gjë e cila mund të ketë sjellë mungesën e transparencës në lidhje me shërbimin e ndërmjetësimit me shoqëritë e sigurimit.
- Nga opinionet e kredimarrësve për çështjen e trajtuar, u konfirmua mënjanimi i kredimarrësit në përzgjedhjen e kompanive të sigurimeve pasojë ndoshta edhe e

indiferencës dhe mosdijes së një pjesë të kredimarrësve apo i mungesës së transparencës së bankave në informimin e klientit.

Për gjithë sa më sipër, me qëllim rritjen e transparencës së bankave, Komisioni i Konkurrencës i rekomandoi Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës së Shqipërisë : bankat e nivelit të dytë pasi të marrin miratimin nga Banka e Shqipërisë duhet të aplikojnë për licencimin nga ana e AMF-së si subjekte të cilat ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurim dhe risigurim (në formën e shoqërive të brokerimit) në rolin e ndërmjetësit që rregullon marrëdhënien midis të siguruarit dhe siguruesit për klientët kredimarrës; detyrimin e bankave të nivelit të dytë për rritjen e transparencës së shërbimit të ndërmjetësimit për sigurimin dhe risigurimin duke ju parashtruar kredimarrësve qartësisht kushtet dhe tarifat e primeve të ofruesve potencial (shoqërive të sigurimit) për llojin e sigurimit të kërkuar nga banka, informacion i cili duhet të jetë i reklamuar qartë dhe koherent; banka e niveli të dytë nuk duhet të përcaktojnë që në kontratën e huadhënien kompaninë e sigurimit ku do sigurohet kolateralit dhe prona. Ajo duhet t'u lejojë kredimarrësve të saj të drejtën e përzgjedhjes së kompanisë së sigurimit.

II.7. Rishikimi gjyqësor i çështjeve të Autoritetit të Konkurrencës

Çështjet e konkurrencës po marrin gjithnjë e më shumë vëmendje në praktikën gjyqësore europiane dhe më gjerë dhe tashmë disa nga vendimet përfundimtare të Gjykatës Europiane të Drejtësisë janë kthyer në raste ligjore të cilave ju referohen Autoritetet e Konkurrencës dhe palët e interesuara në shqyrtimin e çështjeve kryesore lidhur me marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimin me pozitën dominuese.

Eksperienca e rishikimit gjyqësor të vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës në Shqipëri është ende në fazat fillestare dhe për këtë arsye në bashkëpunim me projektet e Bashkimit Europian dhe qendrën e OECD-së në Hungari, është synuar nëpërmjet trajnimeve, rritja e shkallës së njohjes dhe interpretimeve të Gjyqtarëve për çështje të konkurrencës. Trajnimet janë zhvilluar në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë nga ekspertët e BE-së dhe në qendrën rajonale të OECD-së në Budapest, ku kanë marrë pjesë disa gjyqtarë.

Procesi i rishikimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës për rastin e vendimeve me masë administrative (gjobë) ka shënuar progres në kuptim të rritjes së shkallës së mbrojtjes ligjore të vendimeve të Komisionit përpara Gjykatës. Për të siguruar konfirmimin nga Gjykata të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, jemi përqendruar gjerësisht në argumentimin ligjor të praktikave të kufizimit të konkurrencës nëpërmjet abuzimit me pozitën dominuese dhe marrëveshjet e ndaluara. Në procesin e rishikimit Gjyqësor, Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të KPr.C ka qenë proaktiv në ndjekjen e rasteve të ekzekutimit të vendimeve që kanë marrë formë të prerë pas vendimit të Gjykatës së Apelit për t'ju nënshtruar ekzekutimit me shërbimin përmbartimor publik. Një paraqitje më e detajuar e të gjithë procesit të rishikimit gjyqësor prezantohet në shtojcën nr.6.

Nga analiza e procesit të rishikimit gjyqësor rezulton se përgjithësisht kërkohet një kohë e gjatë që nga dalja e vendimit të Komisionit të Konkurrencës deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata e Lartë. Nga 6 raste të rëndësishme të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës për abuzim me pozitën dominuese dhe marrëveshje të ndaluara, vetëm për një rast ka përfunduar i gjithë cikli i rishikimit gjyqësor, ndërkohë që të gjitha vendimet e tjera janë në proces rishikimi në njërin nga shkallët e gjyqësorit.

Në se i referohemi statistikave, duke filluar nga viti 2005, (nga ku daton Vendimi i Komisionit të Konkurrencës e parë me masë ndëshkimore dhe ankimuar në sistemin gjyqësor) dhe deri në fund të vitit objekt-analize në atë sistem dhe më konkretisht iniciuar që nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (shkalla e parë e gjyqësorit) janë regjistruar dhe ankimuar 33 padi. Nga shqyrtimi i tyre deri në fund të vitit të kaluar, rezulton se janë fituar 17 raste, janë humbur 6 dhe janë në proces 10 të tilla. Ndërsa në Gjykatën e Apelit janë apeluar 24, por vetëm 20 i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor. Deri në fund të vitit të kaluar rezulton se nga çështjet që janë shqyrtuar në atë gjykatë, 4 raste janë shqyrtuar, 2 raste të humbura, 2 fituar dhe 4 janë në proces shqyrtimi, duke evidentuar edhe kalime të disa çështjeve në Gjykatën e Apelit Administrativ. Ndërkohë në Gjykatën e Lartë janë rekursuar 14 çështje, nga të cilat janë fituar 4, janë humbur 1 dhe 9 çështje janë në proces. Pra, duke përmbledhur, statistikave të mësipërme paraqiten në mënyrë të detajuar në shtojcën “Pasqyra e rishikimit gjyqësor të VKK”.

Gjithashtu në se i referohemi 20 VKK që janë për vendosje gjobe, vetëm disa prej tyre kanë marrë formë të prerë (kryesisht në Apel) dhe janë kthyer në Urdhra Ekzekutimi, një prej tyre është humbur dhe 14 janë në shkallë të ndryshme të gjyqësorit (9 në Gjykatë të Lartë), pa përfshirë këtu 4 prej tyre të kaluar tashmë në shkallët e gjyqësorit administrativ. Këta janë treguesit e VKK, i cili ndërhyt ex-post duke synuar mirëfunksionimin e tregjeve. Ky fakt përbën një nga problemet që e kufizojnë rritjen e efektit të ndërhyrjeve në treg prej institucionit të konkurrencës. Vendimi i Komisionit të Konkurrencës për vendosje gjobe ndaj një ndërmarrje në tregun e telefonisë celulare për mosdhënien e informacionit gjatë procedurës hetimore, e dhjetorit 2005, është shqyrtuar pas rekursit të Autoritetit për të cilën Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin për rigjykim në Gjykatën e Apelit. Për këtë rast, rekursi i Autoritetit të Konkurrencës është depozituar që në vitin 2008, por ende nuk është gjykuar, duke evidentuar problematikën e kohëzgjatjes së trajtimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës në sistemin gjyqësor, i cili përbën një nga shqetësimet kryesore pasi lidhet me efektin që sjellin ndërhyrjet në treg të Autoritetit të Konkurrencës.

Në këtë këndvështrim, fillimi i Gjykatës Administrative në fillim të këtij viti, përbën edhe një instrument shumë të rëndësishëm, i cili do të ndikojë jo vetëm në shkurtime dhe afateve, por pritet që edhe shkalla e ekspertizës së trajtimit të çështjeve të konkurrencës të përmirësohet ndjeshëm, duke sjellë edhe rritjen e cilësisë së analizave institucionit të konkurrencës si dhe të vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës.

Analiza ilustruese e rasteve të rishikimit gjyqësor

Rasti 1- Gjykata lë në fuqi vendimin për gjobë ndaj kompanive celulare

Me vendimin nr.59, datë 09.11.2007 “Për abuzim me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme të shoqërisë AMC SHA dhe Vodafone Albania SHA” Komisioni i Konkurrencës ka provuar se shoqëritë AMC dhe Vodafone kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun e telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës objekt-hetimi(2004-2005). Për shkeljet e konstatuara shoqëritë AMC dhe Vodafone janë gjobitur me 2 % të xhiros vjetore, respektivisht 211 552 000 lekë dhe 242 633 000 lekë.

Kompanitë e ankimuan vendimin në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë veç e veç. Në vendimin për pjesën e AMC-së, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 172 të datës 19 janar 2009 ka mbështetur konkluzionin e Komisionit të Konkurrencës. Sipas vendimit të Gjykatës, tarifat e shërbimit të telefonisë celulare në Shqipëri të krahasuara me tregjet e tjera gjeografike janë tepër të larta. Duke patur në konsideratë sa është analizuar për vërtetimin e testeve të përcaktuara nga BE, gjykata arrin në përfundimin se AMC ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg. Për rrjedhojë konkludon Gjykata, Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 59, datë 09.11.2007 është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Edhe Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndërkohë që pritet që çështja të shqyrtohet nga ana e Gjykatës së Lartë pas rekursit të AMC-së.

Rasti 2- Gjykata shkallës parë konfirmon, Gjykata apelit rrëzon vendimin për sigurimet

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 246, datë 09.10.2002 ka vendosur gjobë për kufizim të konkurrencës në tregun e sigurimeve të detyrueshme. Në total gjoba arrinte vlerën e 88 944 664 lekë. Rezulton se ndërmarrjet objekt hetimi që ushtrojnë veprimtari në tregun e MTPL-së së brendshme, duke filluar nga data 1 shkurt 2012 deri në datë 8 shkurt 2012, kanë rritur në mënyrë të njëkohshme dhe kanë fiksuar primin e sigurimit për të gjitha klasat e produktit MTPL e brendshme me përjashtim të ndërmarrjes INSIG SHA për klasën B1/1. Kjo sjellje përbën një praktikë të bashkërenduar, e cila në kuptim të nenit 3, pika 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” konsiderohet marrëveshje, si dhe në bazë të nenit 4, pika 1 germa a është marrëveshje e ndaluar, dhe në kuptim të Ligjit konsiderohet shkelje e rëndë e konkurrencës. Palët kanë ankimuar vendimin dhe Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 3877, datë 12.04.2013 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë, por është rrëzuar nga Gjykata e Apelit, Tiranë.

Kundër këtij Vendimi nga ana e ndërmarrjeve u krye ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila vendosi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar padinë. Gjykata e Shkallës së parë ka pranuar argumentimin e Komisionit mbi ekzistencën e një praktike të bashkërenduar në formën e një marrëveshje të ndaluar dhe ka lënë në fuqi masën administrative(gjobë) për shoqëritë e sigurimit.

Gjykata e Apelit është shprehur se “*Autoriteti i Konkurrencës gjatë vendimmarrjes së tij nuk arriti të provonte se ka ndonjë marrëveshje të çdolloj qoftë apo sjellje të bashkërenduar me qëllim dëmtimin e parimeve të konkurrencës së lirë, sikurse i liston dhe parashikon neni 4 i Ligjit të Konkurrencës. Gjithashtu nuk u arrit të provohej se me anë të çfarëdolloj marrëveshje kompanitë kanë caktuar çmime të njëjta*”. Kundër këtij Vendimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është kryer rekurs në Gjykatën e Lartë ku është argumentuar se vendimi i Gjykatës së Apelit është marrë në zbatim të

gabuar të ligjit material, në keqinterpretimin e provave dhe si i tillë është i cenueshëm. Pretendimi i Gjykatës se në raportin hetimor nuk rezulton ndonjë marrëveshje e ndaluar nuk është i vërtetë pasi nga të dhënat e marra nga inspektimet e ndërmarrjeve rezultoi se për periudhën 1 shkurt deri më 8 shkurt 2012, shoqëritë e sigurimit kanë rritur dhe fiksuar çmimin duke shitur produktin MTPL me të njëjtin prim pavarësisht se janë ndërmarrje të ndryshme me karakteristika të ndryshme dhe në këtë mënyrë është kufizuar mundësia e zgjedhjes konsumatore.

Nga Gjykata e Lartë pritet shpallja e datës së gjykimit.

d) Ekzekutimi i vendimeve

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 80 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i është drejtuar Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë të poshtë shënuar, e më konkretisht:

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 154, datë 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes “Classic” sh.p.k. dhe “Noti” sh.p.k.) “Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k., “Hyundai” sh.p.k., “Noti” sh.p.k. dhe “Ultra Motors” dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”, për të cilin është lëshuar Urdhër Ekzekutimi me anë të Vendimit nr. 2384, akti datë 19.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 216, datë 01.03.2012, “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes “INTERSIG” SHA, për të cilin është lëshuar Urdhër Ekzekutimi me anë të Vendimit nr. 3763 Akti, datë 14.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr.265, datë 05.02.2013, “Mbi vendosje gjobe ndaj shoqërisë Viloil Sh.a për mosnjoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Viloil Sh.a nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investment Holding S.A” tek aksionarët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”, për të cilin është lëshuar urdhër ekzekutimi me anë të Vendimi nr. 7677, akti datë 20.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Në zbatim të Kodit të Proçedurës Civile, Autoriteti i Konkurrencës ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur për të bërë të mundur ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutivë nga ana e Zyrës së Përmbarrimit.

Një formë statistikore për ekzekutimin e gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës në formë të akumuluar paraqitet në shtojcën nr. 2 “Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës deri më 31 Dhjetor 2013”.

II.8. Përafrimi i legjislacionit në fushën e konkurrencës.

Pjesë e objektivave të Autoritetit të Konkurrencës është realizimi i detyrimeve institucionale të saj në kuadër të procesit të integritit europian dhe përafrimi ligjor e rregullativ me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian. Këto detyrime rrjedhin nga

Marrëveshja e Stabilizim – Asocimit (MSA) BE-Shqipëri, e cila rregullon marrëdhëniet BE-Shqipëri.

Kjo marrëveshje parashikon adoptimin e *acquis communautaire* (tërësisë së rregullave dhe normave të BE-së) në sistemin juridik të brendshëm të Shqipërisë. Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Autoritetin e Konkurrencës parashikohen në nenet 71 dhe 72 të MSA që parashikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive nga veprimet dhe praktikant anti-konkurrese që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë si dhe roli i institucionit tonë në rastet e të drejtave ekskluzive apo të veçanta, dhënë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Një nga detyrimet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës është përfarimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e konkurrencës. Në përmbushje të këtij objekti, Autoriteti i Konkurrencës edhe përgjatë 2013 ka vijuar procesin e hartimit të akteve nënligjore, duke përafuar plotësisht aktet ligjore të BE-së. Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), institucioni ka draftuar rregullore të cilat japin përjashtime nga marrëveshjet e ndaluara. Këto rregullore parashikojnë dispozita në lidhje me ato lloj marrëveshjesh të cilat mund të kenë një efekt real në treg, dhe përjashtohen në grup në varësi të natyrës së marrëveshjes ose sektorit të tregut përkatës. Çdo rregullore parashikon kriteret të veçanta në lidhje me pjesët e tregut të palëve, me llojin e kufizime që përmban marrëveshja , apo në lidhje me përfitimet nga efica qe ajo duhet të sjellë me qëllim që të përjashtohet nga ndalimi.

Rregullorja “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”¹ Objekti i rregullores është përjashtimi nga ndalimi i kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve. Kjo rregullore përcakton llojet e marrëveshjeve që përjashtohen nga ndalimi, pjesët përkatëse të tregut që duhet të zënë këto marrëveshje me qëllim që të klasifikohen në këtë kategori, përfitimet nga efica qe ato sjellin, efektet e mundshme negative dhe pozitive në treg, etj.

Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror”,² Objekt i rregullores është përjashtimi nga ndalimi i kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror. Sipas kësaj rregulloreje përcaktohet fusha e zbatimit të saj, dhe qartësohen rastet kur këto lloj marrëveshjesh dhe praktikash nuk do të konsiderohen si të ndaluara, ose me vendim të Komisionit të Konkurrencës do të jepet përjashtimi, bazuar në pjesën e tregut, përfitimet nga efica qe, natyrën e marrëveshjeve etj.

¹ Është përshtatur Rregullorja e Komisionit të BE-së Nr. 267/2010, të datës 24 Mars 2010 “Mbi zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve”.

² Është përshtatur Rregullorja e Këshillit Evropian Nr 487/2009 e datës 25 Maj 2009, “Mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori marrëveshjesh dhe praktika të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror” (32009R0487).

Udhëzimi “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”³. Qëllimi i rishikimit dhe hartimit të këtij udhëzimi është përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar në fushën e konkurrencës me atë të BE-së, duke sjellë frymën dhe risitë e udhëzimit të BE-së. Ky udhëzim përcakton parimet për vlerësimin e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara të ndërmarrjeve, (që janë pjesë e një bashkëpunimi horizontal), përkufizimi i llojeve të marrëveshjeve horizontale, mënyra se si përcaktohet tregu përkatës, vlerësimi nëse është marrëveshje e ndaluar apo jo, kufizimet e mundshme të konkurrencës që mundet t’i sjellë kjo lloj marrëveshje, përfitimet nga efica qe sjell marrëveshja e lidhur, domosdoshmëria që ka kjo marrëveshje, kalimi i efekteve pozitive tek konsumatorët, etj.

³ Është përshtatur Udhëzuesi i BE-së “Për zbatueshmërinë e nenit 101 mbi funksionimin e bashkimit evropian për marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit” (007252011XC0114(04))

III. ADVOKACIA DHE KULTURA E KONKURENCËS

Advokacia dhe përhapja e kulturës së konkurrencës përbëjnë kolonën e katërt të punës së Autoritetit të Konkurrencës. Për të krijuar një ambient sa më konkurrues në mënyrë që pjesët e tregut të fitohen mbi bazën e meritës dhe jo të mbështetjes nga organet shtetërore apo praktikant antikonkurruese (abuzim me pozitën dominuese dhe marrëveshje të ndaluara), Autoriteti i Konkurrencës i kushton një vëmendje në rritje advokatisë së ligjit dhe politikës së konkurrencës dhe rritjes së shkallës së njohjes së ligjit nga aktorët dhe faktorët e tregut.

III.1 Vlerësimi i akteve dhe draft-akte normative.

Ambienti për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg është në funksion të aktivitetit të një sërë institucionesh qendrorë dhe vendore, përfshirë ministritë, entet rregullatorë, bashkitë etj.

Në bazë të nenit 69 të ligjit organet e administratës qendrorë dhe vendore duhet të kërkojnë vlerësimin e autoritetit për çdo projekt akt normativ që ka të bëjë kryesisht me kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, vendosjen e të drejtave ekskluzive.

Është detyrë ligjore e autoritetit të vlerësojë shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës, por me gjithë rolin proaktiv të autoritetit që me nismën e tij të bëjë vlerësimin e këtyre akteve, kjo nuk ka qenë gjithnjë e mundur për shkak të neglizhimit që bëjnë institucionet për marrjen e opinionit të autoritetit përpara miratimit të akteve që sjellin kufizime të konkurrencës.

Me mbështetjen e projektit të asistencës teknike të be-së autoriteti i konkurrencës ka propozuar dhe tashmë është implementuar një matricë e vetëvlerësimit të impakteve të akteve ligjore dhe/ose nënligjore në konkurrencë, si një instrument ndihmës për të gjitha institucionet për të bërë vetë paraprakisht procesin e ndikimit të një akti në kufizimet e mundshme të konkurrencës në treg.

Në vijim paraqiten të listuara aktet dhe projekt aktet ligjore të paraqitura për mendim pranë autoritetit të konkurrencës, për të cilat janë kryer vlerësimet ligjore.

Projekt-ligjin “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 "për pronësinë industriale”;

Projekt-marrëveshjen tip për shërbimin e transmetimit midis ost dhe furnizuesve të kualifikuar;

Projekt-marrëveshja e bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta mtpj;

Draft-rregullat “për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”;

Draft-rregullat e ankandit të zyrës së koordinuar të ankandëve për Evropën juglindore (see cao);

Kontratën e brokerimit të lidhur ndërmjet star broker sha dhe sigal uniqa group austria sha dhe kontratës së bashkëpunimit mes bkt dhe star broker;

Vlerësim i legjislacionit në fushën e telekomunikacionit, gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës;

Vlerësim i legjislacionit në fushën e transportit qytetas të udhëtareve, gjatë procedurave hetimore në atë treg përkatës;

Vlerësim i vendimit të bordit të amf nr. 86, datë 22.06.2012, për miratimin e kushteve e përgjithshme të kontratës së sigurimit kufitar të përgjegjësive të mbajtësve të mjeteve motorike, gjatë procedurës së monitorimit të tregut të sigurimeve;
Vlerësim ligjor i vendimit të ere nr. 42, datë 25.05.2009, “rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga ossh sha (kompania)”, gjatë shqyrtimit të ankesës së ndërmarrjes “gen-i” sha.

III.2. Dhënia e rekomandimeve

Autoriteti i Konkurrencës gjatë procedurave të monitorimit dhe të hetimit, analizon faktorët që ndikojnë në mirëfunksionimin e tregjeve respektive, duke identifikuar rolin promovues apo kufizues që mund të luajnë aktet ligjore apo nënligjore të institucioneve rregullatorë apo qendrorë. Në tërësi rekomandimet që ka adresuar Komisioni i Konkurrencës janë paraqitur në pjesët përkatëse të raportuara për procedurat e veçanta sipas tregjeve të monitoruara apo të hetuara, si dhe në shtojcën nr. 7 “Matrica e rekomandimeve nga Komisioni i Konkurrencës për vitin 2013”. Në vijim paraqiten rekomandimet në tregjet të cilat nuk janë prezantuar.

Në tregun e sigurimeve të detyrueshme

Tregu i sigurimeve ka qenë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës për shkak të shqetësimeve për konkurrencën si pasojë e sjelljes së ndërmarrjeve në treg dhe/ose vendimmarrjes rregulative të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.269, datë 18.02.2013, “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e policës së sigurimit kufitar”, Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe të gjitha ndërmarrjeve të sigurimit rishikimin, brenda afatit 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kushteve të veçanta të Policës së Sigurimit Kufitar në mënyrë që shoqëritë e sigurimeve ta tregtojnë produktin “Policë kufitare” me emrin e secilës prej tyre, në mënyrë individuale.

Autoriteti i Konkurrencës ka rekomanduar që para miratimit të kushteve, të përgjithshme dhe të veçanta, të kontratës së sigurimit, që shoqëritë e sigurimit do të hedhin në treg, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Byroja Shqiptare e Sigurimeve duhet të sigurojnë që sjellja e shoqërive të sigurimit në treg të jetë në mënyrë individuale në përcaktimin dhe aplikimin e çmimit të shitjes së produktit policë kufitare për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta.

Në tregun e transportit qytetas

Pas përfundimit të procedurave në tregun e transportit qytetas, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr.349 Prot. datë 2.10.2013 i ka rekomanduar Bashkisë së Tiranës realizimin e një studimi në përcaktimin e metodologjisë së shpërndarjes së aboneve për secilin operator në përputhje me zhvillimet e tregut si dhe plotësimin e kartonit shoqëruar të aboneve me të gjithë elementët identifikues dhe të sigurisë.

Bashkia e Tiranës me shkresën nr. 9787/3 Prot. datë 18.11.2013, e ka informuar Autoritetin e Konkurrencës mbi studimin e Institutit të Studimeve të Transportit “Mbi rregullimin e sistemit të shpërndarjes së aboneve në qytetin e Tiranës”. Gjithashtu, pas administrimit të ankesave nga dy operatorë dhe marrjes së informacionit nga të gjithë operatorët, Bashkia ka informuar se do të marrë vendimin për rishpërndarjen e biletave të pajtimit mujor.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 349/2, datë 24/10/2013, i ka kërkuar Bashkisë së Tiranës që para vendimit përfundimtar t'i vërë në dispozicion metodologjinë për mënyrën e shpërndarjes së biletave mujore si një detyrim ligjor i parashikuar në nenet 69 dhe 70 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III.3 Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe udhëzues mbi zbatimin e ligjit të konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës edhe përgjatë 2013 ka bashkëpunuar ngushtësisht me rregullatorët në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, për promovimin e politikës së konkurrencës dhe rritjes së kulturës së konkurrencës në të gjithë sektorët e ekonomisë. Tryeza të përbashkëta për diskutimin e problematikave të cilat janë identifikuar në tregjet e rregulluara janë mbajtur me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, me Autoritetin për Komunikimet Elektronike dhe Postare, me Entin Rregullator të Energjisë, me Agjencinë e Prokurimeve Publike, me Bankën e Shqipërisë, etj., si në nivele ekspertësh ashtu edhe me bordet vendimmarrëse.

Autoriteti i Konkurrencës ka qenë pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke dhënë mendimin konkret për konkurrencën në sektorin përkatës. Gjithashtu, ka bashkëpunuar ngushtësisht me secilin nga entet rregullatorë për rastet konkretet të cilat janë paraqitur për shqyrtim në Autoritetit. Është respektuar dhe konsultuar mendimi i dhënë nga entet rregullatorë, duke pasqyruar këtë opinion të dhënë në vendimet përkatëse përfundimtare.

III.4 Kultura e konkurrencës – marrëdhëniet me publikun dhe mediat

Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës, si në përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparence maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, ashtu edhe për rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj vendimeve të Komisionit të Konkurrencës. Një komunikim transparent ndihmon në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes si dhe në përcjelljen e duhur të frymës së institucionit. Në këtë kuadër, është vlerësuar si shumë i rëndësishëm komunikimin ndërveprues me publikun.

Autoriteti i Konkurrencës përdor një sërë kanalesh komunikimi për informimin e publikut, me qëllim që të shpjegojë sa më qartë objektivin e veprimtarisë së institucionit. Ndër to mund të përmendim:

- Marrëdhëniet me median: Për të patur një komunikim sa më transparent, vihen në funksion një sërë instrumentesh, ndër të cilat përmendim median e shkruar dhe atë vizive, që siguron informimin në kohë reale mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës dhe tregjet apo sektorët e ekonomisë në të cilat Autoriteti ndërhyr për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.
- Daljet në publik: Rëndësi e veçantë i kushtohet fjalimeve, prezantimeve dhe materialeve të mbajtura në aktivitete të ndryshme organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës apo edhe organizma të tjerë, ku është prezantuar aktiviteti dhe veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës.
- Botimet: Botimet ofrojnë informacion të zgjeruar e të përditësuar mbi çështje dhe tema të ndryshme të konkurrencës, mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës apo edhe mbi gjithë veprimtarinë e institucionit. Ndër botimet kryesore përmendim Buletinin e Vendimeve për vitin 2012; Raportin Vjetor 2012 dhe synimet për 2013

Faqja e internetit: Gjatë vitit 2013 është ofruar transparencë e plotë duke publikuar në kohë reale çdo Vendim të Komisionit të Konkurrencës si dhe nëpërmjet njoftimeve për shtyp është transmetuar informacion mbi aktivitetin e institucionit, analiza dhe studime të ndryshme të ndërmarra në treg, raporte të ndryshme apo publikime të institucionit etj. Gjithashtu është punuar që kjo faqe e internetit të plotësohet e përditësohet me informacione të tjera duke e bërë më interaktive dhe më të lehtë për t'u përdorur nga vizitorët e faqes. Kjo faqe është lidhur me rrjetet sociale për të rritur numrin e vizitorëve e promovimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. të praktikave abuzuese

IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në kuadër të proceseve integruese të Shqipërisë drejt Bashkimit European Autoriteti i Konkurrencës ka thelluar bashkëpunimin me Komisionin European, vendet anëtare dhe institucionet që promovojnë parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg si Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës, OECD, vendet e rajonit etj.

IV.1 Bashkëpunimi me Komisionin European

Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të Raportit të Stabilizim-Asocimit për vitin 2013, e cila është paraqitur në shtojcën nr.5 “Kapitulli 8 – Politika e konkurrencës”, analizozi rekomandimet e bëra në këtë raport në lidhje me Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, duke nxjerrë detyrat dhe përgjegjësitë konkrete që parashikonte ky raport dhe duke i kthyer ato në një plan masash administrative për zbatimin dhe plotësimin e tyre. Për zbatimin e këtyre rekomandimeve janë ndarë përgjegjësitë konkrete sipas sektorëve dhe drejtorive të Autoritetit.

Autoriteti i Konkurrencës, si institucioni koordinues për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës” i ka kushtuar rëndësinë maksimale procesit të raportimit të progresit të ndodhur jo vetëm në fushën e konkurrencës, por edhe në fushat për të cilat raporton institucioni. Autoriteti ka bashkëpunuar ngushtësisht me anëtarët e grupit ndër-institucional të punës për Kapitullin 8, në mënyrë që të pasqyrohet sa më realisht dhe qartësisht situata aktuale për sa i përket kuadrit ligjor, aktiviteteve zbatuese, procesit të vlerësimit të konkurrencës dhe ndërhyrjes në tregjet e rregulluara, dhënies së mendimeve dhe opinionëve për të drejtat e veçanta dhe ekskluzivitetet etj.

Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është siguruar paraqitja pranë MIE e materialit “Mbi nën-komitetin për tregun e brendshëm dhe konkurrencën” në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit në prill 2013. Autoriteti i Konkurrencës prezantoi rezultatet e arritura në procesin e përfarimit dhe zbatimit të legjislacionit në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

Sipas Raportit të Komisionit European për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka bërë disa përparime në fushën e konkurrencës dhe pasqyron një progres të konsiderueshëm për sa i përket mbrojtjes së konkurrencës dhe fushës së konkurrencës në përgjithësi.

IV.2. Bashkëpunimi me OECD (RCC Budapest)

Përfaqësues të stafit të Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në workshopet që organizon OECD (RCC, Regional Competition Centre në Budapest) në të cilën inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës paraqesin eksperiencën e institucionit të lidhur me tema të ndryshme si dhe shkëmbejnë eksperiencë me përfaqësues të Autoriteteve Homologe të Konkurrencës. Ndër temat e diskutuar kanë qenë ato lidhur me marrëveshjet e ndaluara, përqendrimet dhe analiza në rastet e përqendrimeve, kultura e konkurrencës etj.

IV.3. Bashkëpunimi me Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN) dhe Autoritet e Rajonit.

Harmonizimi i legjislacionit në fushën e konkurrencës me aktet ligjore të Bashkimit Europian si edhe me tendencat më të fundit ndërkombëtare, ka qenë ndër synimet e rëndësishme në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës. Realizimit të këtyre synimeve i ka shërbyer edhe mbajtja e një komunikimi të vazhdueshëm me institucionet homologe të konkurrencës. Pjesëmarrja aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë, si edhe në forumet e nismat e ndryshme rajonale, i kanë shërbyer reflektimit të praktikave më të mira në nismat rregullatorë të ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës.

Si pjesë e strategjisë së zhvillimit institucional të saj, Autoriteti i Konkurrencës synon të intensifikojë marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin teknik të vendosur me institucionet homologe të konkurrencës. Krahas zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me to, institucioni synon gjithashtu përfitimin e eksperiencës konkrete me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale.

IV.3.1 Bashkëpunimi me Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN) dhe rajonin

Përgjatë 2013 Autoriteti i Konkurrencës ka marrë pjesë dhe është përfshirë, (ashtu sikurse edhe në vitet e mëparshme) në punën dhe aktivitetet e organizuara nga ICN. Përfaqësues të stafit të Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në telekonferencat dhe konferencat e organizuara nga ICN, duke i kushtuar rëndësinë e duhur kësaj pjesëmarrjeje. Gjithashtu, institucioni jonë ka plotësuar disa pyetësorë të ICN lidhur me zbatueshmërinë e ligjit të konkurrencës në Shqipëri si dhe lidhur me aktivitetin e institucionit tonë për zbatimin e rregullave të konkurrencës në vend.

IV.3.2 Bashkëpunimi me vendet e rajonit

Autoriteti i Konkurrencës është një pjesëmarrës aktiv në rrjetin e Autoriteteve të Konkurrencës të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Sofia Competition Forum (SCF) me mbështetjen e UNCTAD, Bashkimit Europian, e shteteve të ndryshme të interesuar në këtë nismë. Autoriteti i Konkurrencës është një nga Anëtarët Themelues që në vitin 2012 e ka kontribuar aktivisht në punimet plenare të këtij forumi e në grupet e punës. Gjatë vitit 2013 Autoriteti i Konkurrencës është përfshirë në hartimin e një studimi të këtij forumi në lidhje me zbatimin e politikës së konkurrencës në vendet e Ballkanit Perëndimor që do të finalizohet gjatë vitit 2014.

IV.4. Bashkëpunimi me Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin – UNCTAD

Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar nga UNCTAD kryerjen e një vlerësimi (Peer Review) të veprimtarisë së këtij institucioni nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin – UNCTAD, dhe shtetet anëtare të kësaj organizate. Ky proces do të kryhet me qëllim vlerësimin e situatës, rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës dhe identifikimin e nevojave për mbështetje

për të përmirësuar veprimtarinë e këtij institucioni dhe institucioneve të tjera të lidhura me mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Ky vlerësim, ndërmerret nga ekspertët e politikave të konkurrencës dhe do të shërbejë si bazë për ekzaminim të shqyrtimit të kolegëve gjatë seancës vjetore të Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve (IGE) .

Ky proces ofron një mundësi unike për të shqyrtuar dhe nxjerrë mësim nga përvojat dhe sfidat me të cilat përballen vendet e ndryshme në zbatimin e politikave të konkurrencës. Raportet e prodhuara gjatë procesit lidhur me gjendjen e ligjit të konkurrencës dhe zbatimin në vende të përfshira janë të paanshëm dhe rigorozë të kryera nga ekspertë të politikës së konkurrencës si nga vende të zhvilluara, ashtu edhe në zhvillim të cilët kanë përvojë praktike në zbatimin e ligjit të konkurrencës .

Procesi i vlerësimit është interaktive dhe kombinon shkëmbimin e përvojave me rekomandime për përmirësime të mundshme qoftë në formulimin e ligjit të konkurrencës ose në zbatimin e tij . Më tej, ai ofron për vendet e interesuara në zhvillim asistencë teknike në rast se ata janë të gatshëm për të zbatuar rekomandimet përkatëse.

Ky proces do të kryhet gjatë vitit 2014 dhe do të finalizohet në vitin 2015.

V. BURIMET NJERËZORE

Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative është një sfidë e vazhdueshme e autoriteteve të reja të konkurrencës për shkak të dinamikës së legjislacionit dhe rasteve të shqyrtimit gjyqësor për aspektet kryesore të zbatimit të ligjit, abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe ndalimin e përqendrimeve që sjellin krijimin ose forcimin e pozitës dominuese.

V.1 *Struktura organizative dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës.*

Struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës gjate vitit 2013 nuk ka patur ndryshime thelbësore dhe paraqitet sipas Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 7, datë 02.02.2012, ndërsa numri i punonjësve është 35 vetë, nga të cilët 24 vetë janë staf teknik i përbërë nga ekonomistë dhe juristë (14 ekonomistë, 9 juristë, 2 informaticienë dhe 1 gjuhë e huaj) si dhe një personeli mbështetës.




Tabela: Përbërja e ekspertëve të Autoritetit të Konkurrencës sipas formimit

V.2 *Struktura organizative.*

Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor. Në shtojcën nr.8 "Struktura e Autoritetit të Konkurrencës" bashkëlidhur është vendosur organograma e Autoritetit të Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës:

Përbëhet nga pesë anëtarë, të votuar në mënyrë nominale nga Parlamenti. Aktualisht Komisioni ka në përbërjen e vet tre ekonomistë dhe dy juristë. Tre nga pesë anëtarët janë në mandatin e tyre të dytë, duke mundur një vazhdimësi në veprimtarinë vendimmarrëse të institucionit. Transparenca, paanësia, barazia, dhe

objektiviteti kanë qenë parimet bazë të funksionimit dhe të vendimmarrjes së Komisionit. Përmirësimi i vazhdueshëm nëpërmjet debatit dhe mendimit alternativ kanë qenë karakteristikat e veprimtarisë së Komisionit të Konkurrencës për forcimin e zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Kabineti

Është njësi që funksionon pranë Komisionit duke asistuar për organizimin dhe mirëfunksionimin e mbledhjeve të Komisionit, ndërlidh punën midis Komisionit dhe Sekretariatit, organizimin e seancave dëgjimore, marrëdhëniet me Kuvendin, marrëdhëniet me mediat, marrëdhëniet me jashtë, kujdesi për instrumentat e advokacisë dhe kulturës së konkurrencës etj.

Sekretariati

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës është organi administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati përbëhet nga tre drejtori dhe sektori i analizës.

Drejtorja mbikëqyrjes dhe e hetimit të tregut realizon procesin e mbikëqyrjes dhe të investigimit të sjelljes së ndërmarrjeve në treg në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë të emërtuar sipas tre shtyllave kryesore që prezantohen në Ligj, pra sektori i abuzimit me pozitën dominuese, sektori anti-kartel dhe sektori i përqendrimeve.

Drejtorja Juridike, e Hetimit dhe Proçedurave realizon argumentimin juridik të produkteve të veprimtarisë së Sekretariatit, merr pjesë në grupet e punës hetimore në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut, dhe përfaqëson Autoritetin në proceset gjyqësore në mbrojtje të Vendimeve të Komisionit ndaj akt-padive nga palët e prekura.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Integritimit Europian është pjesa e strukturës së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës në realizimin e misionit të tij për ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Kjo drejtori realizon përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me atë të BE, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat dhe proçedurat e Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, programon zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme si OECD, ICN, RCC, ITAP, Universiteti i Tiranës etj. Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha proçedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar.

Sektori i studimit dhe analizës ka si mision realizimin e monitorimeve sistematike të tregjeve sipas detyrave të përcaktuara nga vendimet e Komisionit të Konkurrencës, si dhe vëzhgimin e kushteve dhe kryerjen e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregjeve.




Tabela: Ndarja organizative e Autoritetit të Konkurrencës


V.3 Rritja e kapaciteteve administrative

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative përbën një nga sfidat e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës. Aktualisht në këtë institucion prej 35 punonjësish janë me titullin profesor 2 Komisionerë, As prof. 2 Komisionerë, në proçes doktrature 4 vetë, me master 13 vetë nga të cilët 2 në proçes, me diplomë masteri jashtë vendit 3 vetë dhe të diplomuar jashtë vendit 3 vetë.

Në vitin 2013, është realizuar një numër i madh trajnimesh për stafin e Autoritetit të Konkurrencës. Rreth 53 ditë trajnimi për inspektorët dhe stafin menaxherial të Autoritetit të Konkurrencës janë zhvilluar nga ekspertët e Institucioneve homologe, si dhe brenda vendit nga profesorë të Universitetit, kryesisht për analizat ekonometrike. Tematikat e trajnimit janë fokusuar si në aspektin e tregjeve më të rëndësishëm ku ndërhyjnë Autoriteti i Konkurrencës, ashtu dhe sipas ndarjes horizontale, abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara, kontrolli i përqendrimeve etj.

Në kuadër të bashkëpunimit me qendrën rajonale të OECD-së në Hungari janë zhvilluar 20 ditë kalendarikë trajnime nga stafet teknike, ku janë trajnuar për çështje të ndryshme të konkurrencës. Gjithashtu, stafet teknike kanë marrë pjesë në të gjitha seminarët apo tryezat e rrumbullakëta të realizuara nga entet rregullatorë, apo dhe institucionet e tjera.

Proçesi i forcimit të kapaciteteve paraqitet sipas skemës së mëposhtme:



V.4. Menaxhimi financiar.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2013 ka zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit nr.119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”. Administrimi i vlerave materiale dhe monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korrektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore.

Sektori i financës në këtë institucion planifikon dhe ndjek miradministrimin e shpenzimeve buxhetore të miratuara, të cilat janë të lidhura me aktivitetin e institucionit. Në tërësinë e vet ky sektor ka ndikuar në realizimin e objektivave që ka institucioni. Buxheti i miratuar për vitin 2013 është realizuar në masën 99.6%. Informacioni i detajuar jepet në pasqyrën e paraqitur në shtojcën nr.9 “Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2013”.

Mosrealizimi në masën 0.4% ka ardhur kryesisht nga fondet e mbetura nga procedurat e prokurimeve të kryera gjatë vitit.

VI. PRIORITETET PËR VITIN 2014

Forcimi i zbatimit të ligjit dhe të politikës së konkurrencës, kërkon veprimin dhe bashkëveprimin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve, të cilët ndikojnë apo ndikohen në/ nga një treg funksional. Ky është thelbi i eksperiencës 10 vjeçare të Autoritetit të Konkurrencës gjatë zbatimit të ligjit dhe të politikës së konkurrencës.

Misioni për një ekonomi sa më funksionale të tregut, përbën edhe vizionin e Autoritetit të Konkurrencës, i cili është detajuar duke përcaktuar prioritetet për vitin 2014. Eksperiencat e deritanishme në zbatimin e ligjit treguan se : Përsosja e instrumentave investigative nëpërmjet rritjes së shkallës së ekspertizës të inspektorëve të konkurrencës, për të mundësuar evidencat direkte në rastet e marrëveshjeve të fshehta midis lojtarëve të tregut, si dhe thellimi i njohurive në përdorimin e teknikave të analizave ekonomike, për argumentimin me të plotë të abuzimeve me pozitën dominuese, apo realizimin e provës në rastet e mungesës së evidencave direkte në sjelljet e bashkërenduara midis ndërmarrjeve, përbëjnë prioritetet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës, pasi ndikojnë ndjeshëm në rritjen e efikasitetit të ndërhyrjes në treg.

VI.1. Forcimi i zbatimit të ligjit të konkurrencës

Ndërhyrja e Autoritetit do të fokusohet, kryesisht, por jo vetëm, në rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet ndërhyrjes për caktimin e rregullave të lojës në tregjet ku mund të ketë kufizime të konkurrencës së pasojë e marrëveshjeve të ndaluara dhe abuzimit me pozitën dominuese.

Monitorimi i vazhdueshëm i ndërmarrjeve publike ose private, të cilave ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta, si dhe monopoleve me të drejta ushtrimi të veprimtarisë në fushën e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm, është tashmë një prioritet i Autoritetit të Konkurrencës që nga muaji janar i këtij viti.

Trajtimi i ankesave në procedurë dhe përmbajtje do të njohë risi këtë vit lidhur me disa përshtatje të akteve nënligjore mbi mënyrën e trajtimit të ankesave duke siguruar anonimat (në rastet kur kërkohet) dhe trajtimin e shpejtë dhe profesional të ankesave që përputhen me objektin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Por, Autoriteti i Konkurrencës inkurajon çdo lloj ankese të konsumatorit, biznesit apo segmenteve të tjera të tregut, duke u angazhuar në ndjekjen e tyre edhe pranë institucioneve të tjera në rastet kur ankesat janë jashtë objektit të ligjit të konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës do të përfundojë në afatet ligjore hetimet e nisura gjatë vitit 2013 dhe hetimet e reja gjatë vitit 2014 dhe kryesisht të lidhura me tregun e karburanteve, sigurimeve të detyrueshme, mallrave apo produkteve të akcizës si cigaret, pijet alkoolike dhe energjetike etj., dhe do të ndërmarrë hetime sa herë kushtet e tregut të bëjnë të mendosh se konkurrenca është penguar, kufizuar apo shtrembëruar nga sjellja e ndërmarrjeve në treg apo aktet ligjore dhe/ose nënligjore.

Thellimi i bashkëpunimit me entet rregullatorë në funksion të vendosjes së kushteve të konkurrencës së lirë dhe efektive në tregjet e rregulluara është një objektiv i rëndësishëm për Autoritetin e Konkurrencës, për të cilin tashmë kemi marrë

mbështetjen e Kuvendit, i cili i ka kërkuar organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës në dhënien e informacionit dhe konsultimin e përhershëm në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

VI.2 Përafrimi i legjislacionit

Përafrimi i legjislacionit, kryesisht atij sekondar në fushën e konkurrencës, mbetet një prioritet konstant në kuadër të PKZMSA dhe për vitin 2014 është parashikuar përafrimi i rregullores për marrëveshjet në transportin detar, udhëzuesi për marrëveshjet vertikale si dhe udhëzuesi mbi abuzimin me pozitën dominuese.

Gjithashtu, do të vazhdojë procesi i raportimeve të aktivitetit të institucionit pranë Ministrisë së Integritimit Europian, si dhe procesi i përgatitjes së progres raporteve përkatëse, duke pasqyruar nismat ligjore, zbatueshmërinë e ligjit si dhe gjithë veprimtarinë e institucionit tonë. Si koordinues për kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës” Autoriteti i Konkurrencës do të drejtojë procesin e përgatitjes së materialeve përkatës në lidhje me këtë kapitull, duke sjellë informacionin e duhur dhe risitë në periudhat kohore përkatëse.

VI.3. Hartimi i dokumentit të ri të Politikës së Konkurrencës

Nisma e Komisionit të Konkurrencës për të rishikuar dhe ridimensionuar prioritetet e Politikës Kombëtare të Konkurrencës ka filluar të konkretizohet me bashkëpunimin edhe me njësinë e hartimit të strategjive pranë Këshillit të Ministrave. Brenda vitit 2014 Autoriteti në bashkëpunim dhe në konsultim me Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, Këshillin e Ministrave, Entet Rregullatorë, komunitetin e biznesit dhe shoqatat e konsumatorit do të ketë dokumentin e ri të Politikës së Konkurrencës.

Proçesi i vlerësimit mbi zbatimin e ligjit dhe politikës së konkurrencës që do të ndërmerret nga ekspertët ndërkombëtar dhe në bashkëpunim me UNCTAD, do të shërbejë edhe për identifikimin e problematikave që duhet të marrë vëmendjen e duhur gjatë hartimit të versionit të rishikuar të Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Një aspekt në këtë dokument do të jetë përfshirja e rolit të qeverisë vendore për mirëfunksionimin e tregjeve rajonale brenda vendit, për të cilën do të bashkëpunohet me ministrinë përkatëse.

VI.4. Forcimi i kapaciteteve administrative

Sikurse është theksuar në fillim të këtij kapitulli, forcimi i kapaciteteve administrative përbën prioritetin kryesor dhe të vazhdueshme të institucionit të konkurrencës. Vështirësitë e identifikuar gjatë vitit të kaluar për të siguruar evidenca direkte në rastet e dyshuara të marrëveshjeve të ndaluara apo të sjelljes së bashkërenduar tregon për sfidat e së ardhmes. Përballja me këto sfida kërkon që inspektorët e konkurrencës duhet të përsosin instrumentat dhe teknikat e hetimeve, si dhe të rrisin shkallën e tyre të

ekspertizës si në procesin e hetimit ashtu edhe në teknikat e analizave ekonomike, instrument i cili do të aftësojë për rritjen e efektivitetit në grumbullimin e informacionit.

Me rastin e 10 vjetorit të krijimit si institucion i pavarur të Autoritetit të Konkurrencës, në javën e parë të muajit mars zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare Shkencore 'Konkurrenca dhe rritja ekonomike' me pjesëmarrjen e personaliteteve ndërkombëtare në fushën e të drejtës së konkurrencës. Kjo konferencë do të shërbejë edhe për të ndarë eksperiencat dhe shkallën e njohjes dhe zbatimit të së drejtës së konkurrencës në rastin e Shqipërisë, me personalitete të fushës së konkurrencës.

Një sërë trajnimesh dhe seminaresh janë parashikuar gjatë vitit 2014 me mbështetjen e BE-së, OECD, UNCTAD, ICN, etj., ku veçojmë një seminar të financuar nga BE në kuadër të programit TAIEX për zbulimin dhe hetimin e karteleve pa evidenca direkte.

VII. SHTOJCA

Shtojcë 1: Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve

Viti	Vendime në total	Përqendrime	Abuzimin me pozitën dominuese	Marrëveshje të ndaluara	Përjashtime nga marrëveshjet	Rregullore dhe udhëzues	Rekomandime ndaj institucioneve publike	Vendime për vendosje gjore	Masa të përkohshme	Vendime të tjera
2004	13	2				6	1	-		4
2005	17	-				2	3	1		12
2006	14	4				-	1	1		9
2007	25	9	1	3		4	2	5		6
2008	29	11	1		1	4	5	-		7
2009	36	8	1	2	1	2	10	2		12
2010	34	6	3	2	-	7	5	2		11
2011	43	10	2	2	-	6	5	1		18
2012	48	9	2	2	1	5	5	7		24
2013	42	13	0	1	1	3	1	2	1	22
Total	301	72	10	12	4	39	38	21	1	118

Në total janë zhvilluar 17 seanca dëgjimore, 2 tryeza të rrumbullakëta dhe 1 konsultim publik.

Shtojcë 2: Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës deri më 31 Dhjetor 2013

Gjobat e vendosura nga AK	Shuma në lekë	Përqindja ndaj totali⁴
Gjoha të vendosura në total	1.036.999.298	100
Gjoha të mbledhura nga përmbarimi	259.831.233	25.05 %
Gjoha në proces mbledhjeje nga përmbarimi	38.776.000	3.75%
Gjoha për të cilat nuk është marrë ende një vendim gjyqësor (ende pa FP)	738.392.065	71.2%

I. GJOBA TË DERDHURA NË BUXHETIN E SHTETIT NË TOTAL

a) VITI 2013 (Intersig)	664.000 Lekë
b) Vitet paraardhëse	259.167.233 Lekë
Totali i derdhur :	259.831.233 Lekë

II. GJOBA NË PROÇES MBLEDHJEJE NGA PËRMBARIMI PËR 2013

a. "Albanian Airlines"	2.600.000 lekë
b. "Classic"	25.712.000 lekë
c. "Noti"	2.994.000 lekë
d. Subjekti K.Hallka	30.000 lekë
e. Furrtarët e Vlorës	240.000 lekë
f. "Ultra Motors"	1.517.000 lekë
g. "Hyundai"	5.383.000 lekë
h. "Geci "	100.000 lekë
i. "VILOIL"	100.000 lekë
j. "Media vision"	<u>100.000</u> lekë
Totali	38.776.000 lekë

III. GJOBA TË VENDOSURA GJATË VITIT 2013

a) "TIRANA LINES" SHA	1.201.698 lekë (424.080 + 777.618)
b) "TIRANA URBAN TRANS" SHA	2.130.772 lekë (828.274 + 1.302.498)
c) "FERLUT" SHA	1.600.751 lekë (337.133 + 1.263.618)
d) "ALBA-TRANS" SHPK	615.434 lekë
e) "PARKU I TRANS. URBAN	530.906 lekë
f) "VILOIL" SHA	<u>100.000</u> lekë
Totali	6.179.561 lekë

⁴ Shifrat në përqindje janë të rrumbullakosura

Shtojcë 3: Lista e vendimeve shoqëruar me urdhër ekzekutimi

Nr.	Vendimi i Komisionit	Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata	Debitor
1	Nr. 59 datë 09.11.2007 "Vendosje gjobe ndaj AMC SHA dhe Vodafone SHA"	Vendimi Nr. 3359 Akti datë 09.11.2010 (Vetëm për pjesën që i përket AMC)	AMC SHA
2	Nr. 66 datë 18.12.2007 "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e betonit"	Vendimi Nr. 3357 Akti datë 22.12.2010	"Alban Tirana Co", "Best Construction Alb", "Beton Ekspres", "Ferro Beton & Const", "Halili", "Ital – Beton Const", "Kirchberger – Albania", "Qarri - 02", "Shkodra Beton"
3	Nr. 67 datë 24.12.2007 "Marrje sanksioni individual ndaj z. Kajo Hallka"	Vendimi Nr. 3356 Akti datë 10.12.2010	Kajo Hallka
4	Nr. 123 datë 08. 09. 2009 "Vendosje gjobe ndaj Albanian Airlines MAK" SHPK.	Vendimi Nr. 3355 Akti datë 12.11.2010	Albanian Airlines MAK SHPK
5	Nr. 229 datë 03.07.2012 "Vendosje gjobe ndaj <u>GECI SHPK</u> për njoftimin e përqendrimit në shkelje të afatit ligjor"	Vendimi Nr. 9771 Akti datë 29.10.2012	GECI SHPK
6	Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes "Hyundai Auto Albania" sh.p.k.)	Vendimit Nr. 1611 Akti datë 10.02.2012	"Hyundai Auto Albania" sh.p.k.
7	Nr. 239 datë 26.07.2012 "Vendosje gjobe ndaj <u>Media Vizion</u> ",	Vendimit Nr. 9772 Akti datë 09.10.2012	Media Vizion
9	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes " <u>Ultra Motors</u> " sh.p.k.)	Vendimit Nr. 1612 Akti datë 27.02.2012	" <u>Ultra Motors</u> " sh.p.k
10	Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes " <u>Classic</u> " sh.p.k dhe "NOTI" SHPK)	Vendimit Nr. 2384 Akti datë 19.04.2013	" <u>Classic</u> " sh.p.k dhe "NOTI" SHPK
11	Nr. 216, datë 01.03.2012 "Për Vendosje Gjobe ndaj ndërmarrjes "INTERSIG" SHA, për Pengim të Inspektimit"	Vendimit Nr. 3763 Akti datë 14.06.2013	"INTERSIG" SHA
12	Nr. 265, datë 05.02.2013 "Për Vendosje Gjobe ndaj ndërmarrjes VILLOIL" SHA	Vendimi Nr. 7677 Akti, datë 20.12.2013	"VILLOIL" SHA

Shtojcë 4:Përqëndrimet e njoftuara dhe të autorizuara

Nr	Rasti i Përqendrimit	Tregu Përkates	Nr. i Vendimit	Data e Autorizimit	Procedura
1	Viloil Sh.a/City investment Holding Sh.a.	Tregu i karburanteve	265	05.02. 2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
2	Albanian Chrome Sh.p.k /DCM DECO metal GmbH / DCM Beteiligungs GmbH /Balfin Sh.p.k..	Tregu nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit	264	05.02.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
3	Olimpic Air S.A. / Aegean Airlines S.A., / Marfin Investment Group S.A	Tregu transportit ajror të pasagjerëve	267	05.02.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
4	Lion Retail Holding s.a.r.l /Delhaize Serbia d.o.o / Balfin Sh.p.k.	Tregu i pakicë i produkteve ushqimore	268	08.02.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
5	Euromax Sh.p.k / Balfin Sh.p.k /CM Balkans B.V	Tregu i pakicë i produkteve ushqimore	279	22.04.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
6	Japan Tobacco International Netherlands B.V / Nefftekx Eorld II B.V / Batata S.A	Tregu i cigareve	271	26.02.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
7	Bregal Fund III LP / Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP / LR Global Holding GmbH	Tregu i kozmetikeve	272	26.02.2013	Faza e dytë/ Formulari i plotë i njoftimit
8	Investndërtim Tirana Sh.p.k /GPL Construzioni Generali S.r.l / Investment Joti- Infosoft Group	Tregu i ndërtimit	278	15.04.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
9	Hec Bistrica 1 Bistrica 2 Sh.a/ Kurum International Sh.a	Tregu i energjisë	282	30.04.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
10.	HEC Ulëz-Shkopet / Kurum International Sh.a	Tregu i energjisë	281	30.04.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
11.	Tirana International Airport Sh.p.k / Hochtief Airport Retail Sh.p.k / Public Sector Pension Investment Board	Tregu i shërbimet e infrastrukturës aeroportuale	288	25.06.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
12.	AD-Trade /Primo Communications sh.p.k.	Tregu i internetit dhe i telefonisë fikse	294	28.10.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit
13.	Europa Kazino 2009	Tregu i lojërave të fatit dhe kazino elektronike	299	06.12.2013	Faza e parë/ Formulari i thjeshtuar i njoftimit

Shtojcë 5 Kapitulli 8: Politika e konkurrencës⁵

Në fushën **antikartel dhe bashkimet**, Autoriteti i Konkurrencës (AK) miratoi pesë akte nënligjore, të përafuara me *acquis*. Në shtator 2012, AK pothuaj e përgjysmoi tarifën e depozitimit të akteve për bizneset e vogla me xhiro vjetore nga 1,4 milion deri në 7.1 milion Euro.

Autoriteti miratoi gjashtë vendime për marrëveshjet e ndaluara dhe dy për abuzim me pozitën dominuese, si edhe autorizoi 14 bashkime dhe përthithje. AK mori 19 ankesa, pesë më tepër sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar, për shkak se është rritur niveli i ekzekutimit dhe ndërgjegjësimit.

AK-ja përfundoi hetimet në fushën e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për palët e treta dhe gjobiti tetë shoqëri sigurimesh për fiksime të çmimeve të tregut. Pas kryerjes së hetimeve, AK-ja doli në përfundimin se nuk është kufizuar konkurrenca në transportin detar në portin e Vlorës, në importet e sheqerit e orizit, si edhe në tregtimin e vajit vegjetal. Gjithashtu, AK-ja nisi një hetim të thelluar për abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese në tregun e vajrave, çimentos, telefonisë celulare dhe shërbimeve të transportit rrugor në Tiranë.

Autoriteti e rriti numrin e gjobave nga një në 2011, në shtatë në 2012; po kështu edhe numrin e vendimeve të dhëna nga 43 në 2011 në 48 në 2012. Për sa i përket çështjeve të ankimuara, AK-ja fitoi 15 nga 26 çështjet e ankimuara në Gjykatën e Shkallës së Parë si edhe 11 nga 18 që shkuan në Gjykatën e Apelit në 2012. Në gjysmën e parë të 2013, AK-ja fitoi dy dhe humbi një çështje në Gjykatën e Shkallës së Parë. Shumë vendime gjyqësore ende nuk janë marrë, çka ka rezultuar në vonesa të konsiderueshme në arkëtimin e 73% të gjobave të vëna. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të shtuar njohuritë e gjyqësorit mbi legjislacionin në fushën e konkurrencës.

Struktura e re e AK-së pret miratimin në parlament. Kapacitetet administrative u forcuan me punësimin e dy specialistëve, duke e çuar numrin e punonjësve në 36, nga të cilët 24 janë specialistë. Nëpunësit e AK-së janë trajnuar në fusha të ndryshme të legjislacionit të konkurrencës. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të shtuar njohuritë e nëpunësve mbi analizën ekonometrike dhe përdorimin e TIK-ut.

Përfundim

Shqipëria ka bërë përparim të kufizuar në fushën e konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës e përmirësoi performancën e përgjithshme dhe i forcoi kapacitetet administrative.

⁵ Pjesë e Progres Raportit të Komisionit European, marrë nga faqja zyrtare e Ministrisë së Integritimit European: <http://WWW.mie.gov.al/>

Shtojcë 6: Rishikimi gjyqësor i vendimeve të komisionit

a) Rastet në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

1)Shoqëria "Alba Trans" SHPK vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Kundërshtim i Vendimit 290, dt. 23.07.2013 të Komisionit te Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Kundër këtij vendimi nga ana e AK-së është kryer Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë;

2)Shoqëria "Ferlut" vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Kundërshtim i Vendimit 290, dt. 23.07.2013 të Komisionit te Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit;

3)Shoqëria "Tirana Urban Trans" vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Kundërshtim i Vendimit 290, dt. 23.07.2013 të Komisionit te Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit;

4)Shoqëria "Tirana Lines" vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Kundërshtim i Vendimit 290, dt. 23.07.2013 të Komisionit te Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit. Kjo çështje është pushuar nga Gjykata e Tiranës dhe nga ana e palës paditëse nuk u krye Ankim për në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga ana e kësaj ndërmarrjeje është ringritur përsëri kjo çështje dhe është duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;

5)Shoqëria "NAZERI" SHRSF & "DEA" SHRSF vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Shfuqizim i Vendimit Nr. 240, datë 26.07.2012, të Komisionit të Konkurrencës. Në lidhje me këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij Vendimi nga ana e AK-së është paraqitur Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë;

6)Çështja Civile: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve SIGMA Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Atlantik Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Intersig Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve InterAlbanian Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Eurosig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Insig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Albsig Sh.a. Kundërshtimi i aktit administrativ vendimi i Autoritetit te Konkurrencës nr.246 date 09/10/2012 "Mbyllje e Hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" Sh.a, SIGMA Vienna Insurance Group, Atlantik Sh.a, Intersig Vienna Insurance Group, InterAlbanian Sh.a Alb - Siguracion, INSIG dhe Eurosig, vetëm për pjesën që i përket paditësave. Në lidhje me këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjeve, duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij Vendimi nga ana e ndërmarrjeve u krye Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, për të cilin do të flasim më poshtë.

7)Çështja Civile me: Paditësa "Eurogjici Security" Sh.p.k, "Eurogjici, Security 1" Sh.p.k, "Toni Security" Sh.p.k, "Sajmiri AL" Sh.p.k, "Nazeri 2000"Sh.p.k dhe "Dea Security" Sh.p.k", objekt: Kundërshtim i Vendimit Nr. 240 datë 26.07.2012 të Komisionit të Konkurrencës "Për Vendosje Gjobe". Secila nga palët paditëse, ka ngritur padi më vete kundër Autoritetit të Konkurrencës. Në lidhje me këto çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij Vendimi nga ana e AK-së është paraqitur Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë;

8)Çështja Civile me Paditës: Shoqëria "VODAFONE ALBANIA" SHA, i Paditur: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKP), Person i Tretë: Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Detyrimi i ILDKPKI për të nxjerrë aktin administrativ në lidhje me procedimin administrativ me objekt "Verifikimin, hetimin si dhe nisjen e veprimeve ligjore me qëllim shpalljen e pavlefshmërisë dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin nga Vendimi Nr. 258, datë 21 dhjetor 2012; Vendimi Nr. 260, datë 11 janar 2013 dhe Vendimi Nr. 261, date 11 janar 2013 të Komisionit të Konkurrencës". Kjo çështje është duke u gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

b) Rastet ne gjykatën e Apelit Tiranë

Në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2013 kanë qenë për shqyrtim 8 çështje, nga të cilat 4 janë shqyrtuar dhe mbeten 4 për t'u shqyrtuar në 2014.

1)Çështja Civile me paditës: "Shoqëria Tregtare "Romano Port" SHA, të paditur Autoriteti i Konkurrencës, me objekt: Anulim i pikave 1, 2 dhe 3 të Vendimit nr. 221 datë 11.04.2012 të Komisionit te Konkurrencës. Pezullimi i ekzekutimit të Vendimit nr. 221 dt. 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës deri në përfundim të gjykimit të çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 10897 datë 14.11.2012 vendosi: "Pushimin e Gjykimit të kësaj çështjeje civile". Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmon ligjshmërinë e Vendimit Nr. 221 datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi "Romano Port" SHA ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë në lidhje me këtë çështje shpalli moskompetencën lëndore pas vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr. 3, datë 06.12.2013 dhe ja kaloi për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit.

2)Çështja civile me: paditës Shoqëria e Sigurimeve "INTERSIG-VIENNA INSURANCE GROUP" Sh.a, të Paditur Komisioni i Konkurrencës, me objekt: Shfuqizimin, anulimin e vendimit Nr. 216 date 01.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 11473, datë 23.11.2012 vendosi "Rrëzimin e kërkesë padisë". Me anë të këtij vendimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmoi ligjshmërinë e Vendimit Nr. 216 datë 01.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi pala paditëse "INTERSIG" SHA paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs Pala Paditëse, "INTERSIG" SHA;

3)Çështja Civile: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve SIGMA Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Atlantik Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Intersig Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve InterAlbanian Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Eurosig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Insig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Albsig Sh.a. Kundërshtimi i aktit administrativ vendimi i Autoritetit të Konkurrencës nr.246 date 09/10/2012 "Mbyllje e Hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" Sh.a, SIGMA Vienna Insurance Group, Atlantik Sh.a, Intersig Vienna Insurance Group, InterAlbanian Sh.a Alb - Siguracion, INSIG dhe Eurosig, vetëm për pjesën që i përket paditësave. Në lidhje me këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjeve, duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij Vendimi nga ana e ndërmarrjeve u krye Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila vendosi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar padinë. Kundër këtij Vendimi nga ana e AK-së është kryer Rekurs në Gjykatën e Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit..

4)Çështja Shoqëritë e Sigurimit: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve SIGMA Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Atlantik Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Intersig Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve InterAlbanian Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Eurosig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Insig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Albsig Sh.a. Të paditur: Autoriteti i Konkurrencës. Objekti: Marrja e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur pezullimin e zbatimit të aktit administrativ vendimi i Autoritetit të Konkurrencës nr.246 datë 09.10.2012 "Mbyllje e Hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" Sh.a, SIGMA Vienna Insurance Group, Atlantik Sh.a, Intersig Vienna Insurance Group, InterAlbanian Sh.a Alb - Siguracion, INSIG dhe Eurosig. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 736 Akti datë 14.11.2012 vendosi: Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë dhe Pezullimin e zbatimit të vendimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 246 date 09.10.2012, "Mbyllje e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm, motorik ndaj palëve të treta dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve Sigal Uniqa Group Austria Sha, Sigma Vienna Insurance Group Sha, Atlantik Sha, Intersig Vienna Insurance Group, InterAlbanian Sha, Alb -Siguracion, Insig dhe Eurosig sha". Kundër këtij vendimi kemi paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij Vendimi AK-ja paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

5)Çështja Civile me: Paditësa "Eurogjici Security" Sh.p.k, "Eurogjici, Security 1" Sh.p.k, "Toni Security" Sh.p.k, "Sajmiri AL" Sh.p.k, "Nazeri 2000"Sh.p.k dhe "Dea Security" Sh.p.k", objekt: Kundërshtim i Vendimit Nr. 240 datë 26.07.2012 të Komisionit të Konkurrencës "Për Vendosje Gjobe". Secila nga palët paditëse, ka ngritur padi më vete kundër Autoritetit të Konkurrencës. Në lidhje me këto çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij Vendimi nga ana e AK-së është paraqitur Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit;

6)Shoqëria "NAZERI" SHRSF & "DEA" SHRSF vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Shfuqizim i Vendimit Nr. 240, datë 26.07.2012, të Komisionit të Konkurrencës. Në lidhje me këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Kundër këtij Vendimi nga ana e AK-së është paraqitur Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit;

7)Shoqëria "Alba Trans" SHPK vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Kundërshtim i Vendimit 290, dt. 23.07.2013 të Komisionit të Konkurrencës, për pjesën që i takon Paditësit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Kundër këtij vendimi nga ana e AK-së është kryer Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit;

8)Çështja gjyqësore me palë: AMC" SHA vs Autoriteti i Konkurrencës; me Objekt: Anulim i Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Lartë, pas rekursit të paraqitur nga AK-ja, e cila pas shqyrtimit vendosi ta kthejë këtë çështje për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

c) Gjykata e Lartë

Në Gjykatën e Lartë gjatë 2013 kanë qenë 11 çështje për shqyrtim, nga të cilat vetëm 1 është vendosur mospranim i Rekursit të paraqitur nga ndërmarrja Vodafone Albania SHA, duke konfirmuar përfundimisht vendimin e AK-së dhe 1 (një) çështje është shqyrtuar, pas Rekursit të AK-së (AMC SHA), për të cilën Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin për rigjykim në Gjykatën e Apelit, kurse 9 janë për shqyrtim për 2014.

1)Çështja Gjyqësore me Palë: Vodafone Albania SHA vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Pavlefshmëria e Vendimit nr.59, datë 09.11.2008 të Komisionit të Konkurrencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me këtë çështje ka vendosur rrëzimin e Padisë, duke konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit Nr. 216 datë 01.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi pala paditëse "VODAFONE ALBANIA" SHA paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij Vendimi Vodafone Albania SHA kishte paraqitur Rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila pas shqyrtimit të tij, në Dhomë Këshillimi, vendosi mospranimin e rekursit.

2)Çështja Gjyqësore me Palë: AMC SHA vs Autoriteti i Konkurrencës, me Objekt: Pavlefshmëria e Vendimit nr. 59, datë 09.11.2008 të Komisionit të Konkurrencës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me këtë çështje ka vendosur rrëzimin e Padisë, duke konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit Nr. 216 datë 01.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi pala paditëse "AMC" SHA paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij Vendimi pala paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

3)Çështja gjyqësore me palë: AMC" SHA vs Autoriteti i Konkurrencës; me Objekt: Anulim i Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 26 – 27, datë 02.12.2005 dhe 12.12.2005. Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Lartë, pas Rekursit të paraqitur nga AK-ja, e cila pas shqyrtimit vendosi ta kthejë këtë çështje për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

4)Çështja Civile me: Paditës "ARMO" SHA dhe të paditur Autoriteti i Konkurrencës. Objekti i këtij gjykimi ishte: Kundërshtimin e vendimit Nr. 150, dt. 20.07.2010, të Autoritetit të Konkurrencës. Gjykata e Apelit Tiranë me Vendimin Nr. 2441 datë 17.10.2012 vendosi: "Lënien në Fuqi të Vendimit Nr. 5681 datë 28.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr. 5681 datë 28.06.2011 kishte vendosur: Pranimin e padisë dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 150 datë 20.07.2010 të Komisionit të Konkurrencës. Pra, edhe Gjykata e Apelit Tiranë, pavarësisht pretendimeve tona të parashtruara në ankim dhe në seancë gjyqësore, nuk e konfirmoi ligjshmërinë e vendimit Nr. 150 datë 20.07.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij Vendimi AK-ja paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

5)Çështja Civile me: Paditës "Classic" dhe "Noti" SHPK, të paditur Autoriteti i Konkurrencës, me objekt: "Shfuqizimi i aktit administrativ, Vendimit nr. 154 datë 01.10.2010 të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata e Apelit Tiranë, me Vendimin Nr. 2096 datë 10.12.2012 vendosi: "Ndryshimin e Vendimit Nr. 3171 datë 03.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Rrëzimin e padisë së ngritur nga "NOTI dhe CLASSIC" SHPK. Me anë të këtij vendimi Gjykata e Apelit Tiranë, në mënyrë përfundimtare, konfirmoi ligjshmërinë e Vendimit Nr. 154 datë 01.10.2010 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij Vendimi Paditësat paraqitën Rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

6)Çështja Civile me: paditës "Atlas" SHA, të paditur Autoriteti i Konkurrencës dhe Person i Tretë: "Bloja" SHA. Objekti: Shfuqizim i aktit administrative, vendimit nr.125, datë 08.10.2009 të Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me konstatimin e marrëveshjes se ndaluar midis shoqërive "Bloja"SH.A dhe "Atlas"SH.A. Anulimi i gjobës së vendosur në masën 27 848 563 (njëzeteshtatë milion e tetëqind e dyzet e tete mije e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë. Gjykata e Apelit me Vendimin Nr. 979 datë 20.04.2012 vendosi: "Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 359 datë 27.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 359 datë 27.01.2011 kishte vendosur për pranimin e padisë duke e shfuqizuar Vendimin Nr. 125 datë 08.10.2009 të Komisionit të Konkurrencës vetëm për pjesën që i përket "Atlas" SHA. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit kemi paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të datës së gjykimit.

7)Çështja Civile me: Paditës "Bloja" SHA, të paditur Autoriteti i Konkurrencës, me objekt: Shfuqizim i aktit administrative, vendimit nr.125, datë 08.10.2009 të Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me konstatimin e marrëveshjes se ndaluar midis shoqërive "Bloja"SH.A dhe "Atlas" SH.A dhe anulimi i gjobës vendosur "Bloja" SHA. Gjykata e Apelit Tiranë, me Vendimin Nr. 1709, dt. 28.06.2012 vendosi: Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 3198 datë 19. 04. 2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 3198 datë 19.04.2010 kishte vendosur për pranimin e padisë, dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 125 datë 08.10.2009 të Komisionit të Konkurrencës për pjesën që i takon "Bloja" SHA. Me anë të këtyre vendimeve të dyja gjykatat nuk

konfirmuan ligjshmërinë e Vendimit Nr. 125 datë 08.10.2009 duke vendosur që ta shfuqizojnë atë. Kundër këtij Vendimi AK-ja paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

8)Çështja civile me: paditës Shoqëria e Sigurimeve "INTERSIG-VIENNA INSURANCE GROUP" Sh.a, të Paditur Komisioni i Konkurrencës, me objekt: Shfuqizimin, anulimin e vendimit nr.216 date 01.03.2012 te Komisionit te Konkurrencës. Pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 11473, datë 23.11.2012 vendosi "Rrëzimin e kërkesë padisë". Me anë të këtij vendimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmoi ligjshmërinë e Vendimit Nr. 216 datë 01.03.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Kundër këtij vendimi pala paditëse "INTERSIG" SHA paraqiti ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs Pala Paditëse, "INTERSIG" SHA;

9)Çështja Civile me: Paditës "Hyundai" SHPK, të paditur Autoriteti i Konkurrencës, me objekt: "Shfuqizimi i aktit administrativ, Vendimit nr. 154 datë 01.10.2010 të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, lidhur me gjobën për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me këtë çështje ka vendosur pushimin e gjykimit. Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim për në Gjykatën e Apelit Tiranë Pala Padiisë. Gjykata e Apelit Tiranë pas shqyrtimit të çështjes ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur Rekurs Pala Paditëse, "HYUNDAI" SHPK.

10)Çështja Civile: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve SIGMA Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Atlantik Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Intersig Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve InterAlbanian Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Eurosig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Insig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Albsig Sh.a. Kundërshtimi i aktit administrativ vendimi i Autoritetit te Konkurrencës nr.246 date 09/10/2012 "Mbyllje e Hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" Sh.a, SIGMA Vienna Insurance Group, Atlantik Sh.a, Intersig Vienna Insurance Group, InterAlbanian Sh.a Alb - Siguracion, INSIG dhe Eurosig, vetëm për pjesën që i përket paditësave. Në lidhje me këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e padisë së ndërmarrjeve, duke lënë në fuqi vendimin e AK-së. Kundër këtij Vendimi nga ana e ndërmarrjeve u krye Ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila vendosi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar padinë. Kundër këtij Vendimi nga ana e AK-së është kryer Rekurs në Gjykatën e Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit..

11)Çështja Shoqëritë e Sigurimit: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve SIGMA Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Atlantik Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Intersig Vienna Insurance Group Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve InterAlbanian Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Eurosig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Insig Sh.a, Shoqëria e Sigurimeve Albsig Sh.a. Të paditur: Autoriteti i Konkurrencës. Objekti: Marrja e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur pezullimin e zbatimit të aktit administrativ vendimi i Autoritetit te Konkurrencës nr.246 datë 09.10.2012 "Mbyllje e Hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" Sh.a, SIGMA Vienna Insurance Group, Atlantik Sh.a, Intersig Vienna Insurance Group, InterAlbanian Sh.a Alb - Siguracion, INSIG dhe Eurosig. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin Nr. 736 Akti datë 14.11.2012 vendosi: Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë dhe Pezullimin e zbatimit të vendimit të Autoritetit te Konkurrencës nr. 246 date 09.10.2012, "Mbyllje e hetimit te thelluar ne tregun e sigurimit te detyrueshëm, motorik ndaj palëve te treta dhe vendosje gjobe për kufizim te konkurrencës ndaj ndërmarrjeve Sigal Uniqa Group Austria Sha,Sigma Vienna Insurance Group Sha, Atlantik Sha, Intersig Vienna Insurance Group


,InterAlbanian Sha ,Alb -Siguracion , Insig dhe Eurosig sha". Kundër këtij vendimi kemi paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila pas shqyrtimit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij Vendimi AK-ja paraqiti Rekurs pranë Gjykatës së Lartë dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

Shtojcë 7: Matrica e rekomandimeve nga Komisioni i Konkurrencës për vitin 2013

Nr.	Vendimi	Rekomandimi i Autoritetit të Konkurrencës	Sa është marrë në konsideratë
1	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 269, datë 18.02.2013 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e policës së sigurimit kufitar”	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 269, datë 18.02.2013 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e policës së sigurimit kufitar”, vendosi: “1. T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe të gjitha ndërmarrjeve të sigurimit: • Rishikimin, brenda afatit 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kushteve të veçanta të Policës së Sigurimit Kufitar në mënyrë që shoqëritë e sigurimeve ta tregtojnë produktin “Policë kufitare” me emrin e secilës prej tyre, në mënyrë individuale. 2. Para miratimit të kushteve, të përgjithshme dhe të veçanta, të kontratës së sigurimit, që shoqëritë e sigurimit do të hedhin në treg, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Byroja Shqiptare e Sigurimeve duhet të sigurojnë që sjellja e shoqërive të sigurimit në treg të jetë në mënyrë individuale në përcaktimin dhe aplikimin e çmimit të shitjes së produktit policë kufitare për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta.”	
2.	Shkresa me Nr. 327/4 Prot, datë 04.12.2013 “Mbi disa rekomandime për sektorin financiar”.	Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit mbi marëdhëniet midis bankave dhe shoqërive të sigurimit, si dhe opinioneve të Bankës së Shqipërisë dhe AMF-së, me qëllim rritjen e transparencës dhe zgjedhjeve të konsumatorit për produktet e sigurimit në sistemin bankar, i rekomandon: Bankës së Shqipërisë, AMF-së dhe Shoqatës shqiptare të Bankave: 1. “Bankat e nivelit të dytë pasi të marrin miratimin nga Banka e Shqipërisë duhet të aplikojnë për Licensimin nga ana e Autoritetit	

		<p>të Mbikëqyrjes Financiare si subjekte të cilat ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurim dhe risigurim (ne formen e shoqërive të brokerimit) në rolin e ndërmjetësimit që rregullon marrëdhënien midis të siguruarit dhe siguruesit për klientët kredimarrës, sipas parashikimeve të Ligjit 9267, dt. 29.07.2013 “Për veprimtaritë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”;</p> <p>2. Detyrimin e bankave të nivelit të dytë për rritjen e transparencës së shërbimit të ndërmjetësimit për sigurimin dhe risigurimin, duke ju parashtruar kredimarrësve qartësisht kushtet dhe tarifat e primeve të ofruesve potencial (shoqërive të sigurimit) për llojin e sigurimit të kërkuar nga banka. Ky informacion të jetë i reklamuar qartë dhe koherent;</p> <p>3. Bankat e nivelit të dytë nuk duhet të përcaktojnë që në kontratën e huadhënien kompaninë e sigurimit ku do sigurohet kolateralit dhe prona. Ajo duhet tu lejojë kredimarrësve të saj të drejtën e përzgjedhjes së kompanisë së siguruesit.”</p>	
3	Shkresa nr.349prot. datë 2.10.2013 “Mbi rekomandimet e AK për tregun e transportit qytetas”	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr.290, dt. Dt.23.7.2013 i ka rekomanduar Bashkisë së Tiranës për: “1.Realizimin e një studimi në përcaktimin e metodologjisë së shpërndarjes së aboneve për secilin operator në përputhje me zhvillimet e tregut.</p> <p>2. Plotësimi i kartonit shoqëruar të aboneve me të gjithë elementët identifikues dhe të sigurisë.”</p>	
4	Shkresa nr.308/15prot.dt 3.12.2013 “mbi ankesën e Gen-I vs. CEZ për procedurat e Blerjes se energjisë”	<p>Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit mbi procedurat e blerjes se energjisë nga CEZ Sh.a. i rekomandon ERE: Hartimin e rregullores për procedurat e blerjes mujore të energjisë elektrike dhe mbulimin e humbjeve bazuar në: a. Parimet e transparencës së procesit, mosdiskriminimit, &trajtimit të barabartë të konkurrentëve;</p> <p>b. Qartësimin e procedurës së negociimit mes CEZ & ofertuesve, pas shpalljes së ofertave fillestare mbi blerjen e energjisë për mbulimin e</p>	

Shtojcë 8: Struktura e Autoritetit të Konkurrencës



Shtojcë 9: Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2013

	Plani	Fakti	Mbetje	Në %
Shpenzime personeli	42.550.000	42.550.000	0	100%
Kontribute sigurime shoqërore	6.000.000	6.000.000	0	100%
Materiale dhe shërbime				
Ndihme e menjëhershme ekonomike	7.058.000 80.000	7.006.580 80.000	51.420 0	99.2% 100%
Investime	5.000.000	4.822.445	177.555	96,4%
Totali:	60.688.000	60,459.025	228.975	99.6%